



Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo

AUTORITETI RREGULLATOR PËR SHËRBIMET E UJIT
REGULATORNI AUTORITET ZA USLUGE VODE
WATER SERVICES REGULATORY AUTHORITY



RAPORTI VJETOR

2017

Përmbajtja

AKRONIMET DHE SHKURTESAT	4
1. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	5
2. KORNIZA LIGJORE.....	7
2.1. Baza ekzistuese ligjore e cila rregullon funksionimin e ARRU:.....	7
2.2. Vështirësitë ligjore :	8
3. PËRSHKRIMI I INSTITUCIONIT	9
3.1. Vizioni/Misioni	9
3.2. Kompetencat e ARRU, sipas Ligjit	9
4. FUSHËVEPRIMI I AUTORITETIT RREGULLATOR PËR SHËRBIMET E UJIT.....	11
4.1 Organizimi i brendshëm i Autoritetit rregullator për shërbimet e ujit	14
4.2. Bordi.....	15
4.3. Ekzekutivi	15
4.4. Burimet Njerëzore.....	15
4.5. Asetet	15
5. AKTIVITETET PËR PERIUDHËN RAPORTUESE.....	17
5.1. Amandamenti i Ligjit Nr. 05/L - 042	17
5.2. Rrishqyrtimi i Rregullores Nr.02/2016 për Standardet Minimale të Shërbimeve të Ujit në Kosovë.....	17
5.3. Shqyrtimi dhe aprovimi i akteve internet të ofruesve të shërbimeve.....	17
5.4. Përcaktimi i tarifave për vitin 2018-2020.....	18
5.4.1. Përcaktimi i tarifave për shërbimet e ujit	18
5.4.2. Përcaktimi i tarifave për shërbimet e ujit me shumicë.....	21
5.4.3. Politikat tarifore	23
5.5. Monitorimi i përmbushjes së caqeve (objektivave).....	23
5.5.1 Përmbushja e caqeve operative - prodhimi i ujit, uji i pafaturuar, uji dhe ujërat e ndotura të faturuara, numri i konsumatorëve.....	24
5.5.2. Përmbushja e caqeve për shpenzimet operative	25
5.5.3. Përmbushja e caqeve të faturimit dhe arkëtimit.....	25
5.6. Monitorimi i performancës së ofruesve të shërbimit të ujit	26
5.6.1. Mbulueshmëria me shërbime të ujit	28

5.6.2. Uji i Pa faturuar (UPF)	30
5.6.3. Efiçenca e faturimit dhe arkëtimit	31
5.6.4. Proporcioni i konsumatorëve me ujëmatës.....	32
5.6.5. Investimet kapitale për ujësjellës dhe ujëra të ndotura	33
5.6.6 Performanca e NHE-Iber Lepenci.....	33
5.7. Inspektimi dhe zbatimi i standardeve të shërbimit	34
5.7.1. Verifikimi i mënyrës së matjes së ujit të prodhuar në të gjitha pikat e prodhimit.	34
5.7.2. Inspektimi i zbatimit të akteve ligjore, nënligjore, urdhëresave dhe vendimeve të ARRU.	35
5.8. Roli dhe aktivitetet e Komisioneve Këshilluese të Konsumatorëve (KKK)	37
5.9. Aktivitetet në konsolidimin institucional	40
5.9.1. Aktivitetet në planin legjislativ.....	40
5.10. BASHKËPUNIMI ME INSTITUCIONET TJERA	42
5.11. RELACIONET ME PUBLIKUN	44
5.11.1. Bashkëpunimi me media.....	44
6. REKOMANDIMET.....	46
7. RAPORTI FINANCIAR	47
7.1. TË HYRAT NGA TAKSAT E LICENCIMIT 2017.....	48
8. RAPORTIMI RRETH ADRESIMIT TË ZYRËS SË AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM	49

AKRONIMET DHE SHKURTESAT

AKMM – Agjencia Kosovare për Mbrojtjen e Mjedisit

AMK – Agjencin e metrologjisë së Kosovës

ARRU – Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit

BB – Banka Botërore

DANUBIS – programi i benchmarkingut të vendeve të regjionit të Danubit

DWP – Danube Water Program (Programi i Ujërave të Danubit)

ERRU – Enti Rregullator i sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura (Shqipëri)

ESK – Enti i Statistikave të Kosovës

IBNET – International Benchmarking Network (Rrjeti Ndërkombëtar i Benchmarkingut)

IKSHPK – Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik të Kosovës

IWAD – Shoqata ndërkombëtare e kompanive të ujësjellësve në zonën ujëmbledhëse të lumit Danub

KBPZHRMPH – Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis e Planifikim Hapësinor

KE – Komisioni European

KK – Kuvendi Komunal

KKK – Komisionet Këshilluese të Konsumatorëve

KNMU – Këshilli Ndërmintorror i Ujit

KRU – Kompania Rajonale e Ujësjellësit

MIE – Ministria e Integritimeve Evropiane

MMPH – Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor

MSA – Marrëveshja e Stabilizim Asociimit

MZHE – Ministria e Zhvillimit Ekonomik

NHE – Ndërmarrje Hidro Ekonomike

NPK – Ndërmarrja Publike Komunale

Nj.O. – Njësia Operative

NJPM – Njësia për Politika e Monitorim

PUC- Komisionin për Ofruesit e Shërbimeve Publike të Latvisë

SEWRC- Komisioni Rregullator Shtetëror për Energji dhe Ujë të Bullgarisë

SHUKALB – Shoqata e Ujësjellës Kanalizimeve Shqipëri

SHUKOS – Shoqata e Ujësjellësve të Kosovës

TKP – Treguesit Kyç të Performancës

ZKA – Zyra Kombëtare e Auditimit

WAREG – Shoqata e Rregullatorëve Evropian të Ujit

1. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Të nderuar/a,

Në pajtim me nenin 10 të Ligjit për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit (Ligji Nr. 05/L-042), ARRU ka përgatitur Raportin Vjetor të Punës për vitin 2017, i cili paraqet aktivitetet dhe veprimtarinë e ARRU, si dhe një pasqyrë të përgjithshme të gjendjes së sektorit të shërbimeve të ujit në Kosovë.

Edhe pse rregullimi i këtij sektori nënkupton përballjen me shume sfida, ARRU edhe gjatë vitit 2017 ka vazhduar dhe vazhdon të zbatojë praktikën më të mira rregullatore për të siguruar ngritjen e nivelit të shërbimeve të ujit.

Me qëllim të harmonizimit me legjislacionin aktual (me theks në Ligjin për kundërvajtje) dhe rekomandim të Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor të Kuvendit të Republikës së Kosovës, është iniciuar Plotësim Ndryshimi i Ligjit për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit, proces i cili shpresojmë të finalizohet në një afat sa më të shkurtë kohor.

Duke qenë se viti 2017 ka shënuar vitin e fundit të procesit tarifor 2015 – 2017, një ndër angazhimet kryesore të ARRU gjatë këtij viti ka qenë përcaktimi i tarifave për periudhën e ardhshme trevjeçare – Procesi Tarifor 2018 – 2020.

Tarifat për periudhën 2018 - 2020 janë përcaktuar nga të dhënat e Biznes Planeve Rregullatore, të cilat janë aprovuar nga ARRU. Gjatë shqyrtimit dhe aprovimit të Biznes Planeve Rregullatore përmes çaveve konkrete i kemi sfiduar ofruesit e shërbimeve me theks të veçantë në: zvogëlimin e shpenzimeve operative, zvogëlimin e humbjeve të ujit dhe ngritjen e shkallës së arkëtimit.

Sikurse në proceset tarifore paraprake, ARRU është munduar të mbajë ekuilibër për të siguruar që konsumatorët të marrin shërbime të cilësisë më të mirë të mundshme, me një çmim të arsyeshëm duke pasur gjithmonë parasysh edhe qëndrueshmërinë financiare të ofruesve të shërbimeve.

Si çdo vit, edhe gjatë vitit 2017 përmes Raportit të Performancës, ARRU ka vlerësuar ecurinë dhe ngecjet e ofruesve të shërbimeve të ujit. Informatat, analizat dhe të dhënat e këtij raporti të publikuar pasqyrojnë gjendjen e sektorit dhe nivelin e shërbimeve që ofrohen.

Përmes inspektimeve të vazhdueshme në terren, gjatë vitit 2017 ARRU ka përcjellë përmbushjen e Standardeve Minimale të Shërbimit nga ana e ofruesve të shërbimeve, dhe është siguruar që ofruesit e shërbimeve të zhvillojnë aktivitetet e tyre në pajtim me legjislacionin në fuqi.

Përkrahja e Komisioneve Këshilluese të Konsumatorëve në zgjedhjen e ankesave të konsumatorëve të cilët kanë qenë të pakënaqur me përgjigjet nga ofruesit e shërbimeve, ka qenë aktivitet i ARRU gjatë tërë vitit.

Në pajtim me nenin 48 të ligjit Nr. 05/L-042, gjatë vitit 2017, ARRU ka shqyrtuar dhe aprovuar gjithsejtë 35 akte interne të ofruesve të shërbimeve.

Me ndihmën e projektit mbështetës të ARRU, të financuar nga Qeveria Zvicerane, është hartuar udhëzuesi për avancimin e sistemit të monitorimit të ofruesve të shërbimit, është zhvilluar moduli për vlerësimin e të dhënave të raportuara, janë organizuar trajnime për metodologjinë rregullatore të hartimit të planeve të menaxhimit të aseteve, si dhe janë mbështetur të gjithë ofruesit e shërbimeve në procesin e identifikimit dhe vlerësimit të aseteve, fazë kjo që i paraprin hartimit të planeve të menaxhimit të aseteve.

Bashkëpunimi me palët brenda dhe jashtë vendit ka qenë një ndër aktivitetet e ARRU edhe gjatë vitit 2017. Janë përgatitur dhe dorëzuar raportet sipas kërkesave të institucioneve të ndryshme siç janë: MIE, DANUBIS, IBNET, WAREG, IWAD, etj.

Vlen të theksohet se ARRU është pranuar si anëtare me të drejta të plota në Rrjetin e Rregullatorëve Evropian të Ujit (WAREG) - shoqatë jofitimprurëse, përmes së cilës është hapur mundësia e bashkëpunimi teknik dhe institucional mes Rregullatorëve, si dhe zhvillimi i dialogut me institucionet përkatëse të sektorit të ujit në nivel Evropian dhe ndërkombëtar.

Është nënshkruar Marrëveshja e Bashkëpunimit me “Komisionin për Ndërmarrje Publike” të Letonisë (Latvisë, institucion rregullator). Nënshkrimi i kësaj marrëveshje na mundëson bashkëpunim më të ngushtë në të gjitha çështjet rregullatore.

Përmes pjesëmarrjes aktive në takime dhe punëtori të organizuara brenda dhe jashtë vendit, kemi dhënë kontribut duke prezantuar përvojat tona, si dhe duke marrë përvojat e mira të institucioneve tjera.

Përkushtimi dhe aktivitetet e ARRU kanë ndikuar dhe ndikojnë në përmirësimin e nivelit të shërbimeve të ujit dhe qëndrueshmërinë e ofruesve të shërbimeve.

Me të njëjtin përkushtim ne do të vazhdojmë të kontribuojmë në krijimin e ekuilibrit të duhur mes ofruesve të shërbimit, politikë-bërësve dhe konsumatorit.

Në fund dua të falënderoj të gjithë deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës për mbështetjen, stafin e ARRU, ofruesit e shërbimeve, projektin mbështetës të ARRU (financuar nga Qeveria Zvicerane) dhe të gjithë bashkëpunëtorët e këtij sektori për punën e tyre.

Raif Preteni



2. KORNIZA LIGJORE

Autoriteti rregullator për Shërbimet e Ujit (ARRU) është themeluar më 26 nëntor të vitit 2004 me Rregulloren e UNMIK-ut 2004/49 në pajtim me Kornizën Kushtetuese të Kosovës. Rregullorja 2004/49 është amendamentuar me Ligjin Nr. 03/L-086 “Ligji për Ndryshimin e Rregullores 2004/49 mbi Aktivitetet e Ofruesve të Shërbimeve të Ujësjetës, Kanalizimit dhe Mbeturinave” të aprovuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës më datë 13 qershor 2008, me ç’rast raportimi i ZRRUK (emërtim i mëhershëm) nga UNMIK-u ka kaluar te Kuvendi i Republikës së Kosovës.

Me hyrjen në fuqi të Ligjit për Mbeturina (Ligji Nr. 04/L-060) më 08 qershor 2012, përgjegjësitë dhe kompetencat e sektorit të mbeturinave janë bartur te Qeveria e Kosovës dhe MMPH, pra që nga miratimi i këtij Ligji, Rregullatori ka pushuar së qeni përgjegjës për rregullimin e veprimtarive të Ofruesve të shërbimeve të grumbullimit të mbeturinave. Duke u nisur nga ky fakt është marrë iniciativa për të propozuar fillimin e procedurave për amendamentimin e Ligjit Nr. 03/L-086.

Nga hyrja në fuqi, me 30 janar 2016, Ligji Nr.05/L-042, i cili ka për qëllim rregullimin e veprimtarive të ofruesve të shërbimeve të ujit paraqet bazën legislative për zhvillimin e aktiviteteve të Autoritetit Rregullator për Shërbimet e Ujit (ARRU).

2.1. Baza ekzistuese ligjore e cila rregullon funksionimin e ARRU:

- Ligji për rregullimin e shërbimeve të Ujit - Ligji Nr.05/L-042

Sipas autorizimeve të dhëna nga kjo bazë ligjore dhe legjisacionit tjetër që ka të bëjë me sektorin e ujit, ARRU përmes akteve nënligjore (Rregulloreve) ka përcaktuar në mënyrë të hollësishme rregullimin e fushave të veçanta për të cilat ky institucion është përgjegjës.

Në vijim janë listuar Rregulloret e ARRU:

- Rregullore për Komisionet Këshilluese të Konsumatorëve për shërbimet e ujit në Kosovë (Nr.01/2016)
- Rregullore për standardet minimale të shërbimeve të ujit në Kosovë (Nr. 02/2016)
- Rregullore për kartën e konsumatorëve të shërbimeve të ujit në Kosovë (Nr. 03/2016)
- Rregullore për Inspektimin e përmbushjes së obligimeve rregullatore nga ofruesit e licencuar të shërbimeve të ujit në Kosovë (Nr.04/2016)
- Rregullore për licencimin e ofruesve të shërbimeve të ujit në Kosovë (Nr. 05/2016)
- Rregullore për ndërprerje nga shërbimet e ujit në Kosovë (Nr. 06/2016)
- Rregullore për përcaktim të tarifave të shërbimit të ujit në Kosovë (Nr. 07/2016)
- Rregullorja e brendshme për përdorimin e automjeteve zyrtare (Nr.01/2016)
- Rregullorja e brendshme për kontrollimin financiar në ARRU (Nr 02-AF/2016)
- Rregullorja për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Autoritetin rregullator për shërbimet e ujit (Nr.03-OB/2016).

Varësisht nga vlerësimet dhe nevojat e paraqitura nga palët e interesit, Rregulloret mund të rishqyrtohen dhe mund të pësojnë ndryshime.

2.2. Vështirësitë ligjore :

Në pajtim me nenin 39 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-042 mbi Rregullimin e Shërbimeve të Ujit, është paraparë që Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit (ARRU) të nxjerr rregulloren për masat ndëshkuese (sanksionuese) në rast të mos respektimit të Ligjit nr.05/L-042 dhe akteve nënligjore të ARRU.

Mirëpo në anën tjetër në shtator të vitit 2016, Kuvendi i Republikës së Kosovës ka miratuar Ligjin për kundërvajtje Nr.05/L-087, dhe hyn në fuqi në janar të vitit 2017, ku parashihet që kundërvajtjet nuk mund të përcaktohen me akt nënligjor.

ARRU iu është drejtuar Komisionit për bujqësi, pylltari, zhvillim rural, mjedis dhe planifikim hapësinor të Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe ka kërkuar opinion ligjor për Rregulloren për masat ndëshkuese dhe të njëjtit kanë rekomanduar që në vitin 2017 të fillohet me Plotësim Ndryshimin e Ligjit për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit.

3. PËRSHKRIMI I INSTITUCIONIT

Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit (ARRU) është autoritet i pavarur, përgjegjës për rregullimin e veprimtarive të ofruesve të shërbimit në Kosovë, i cili bën licencimin dhe rregullimin ekonomik të ofruesve të shërbimeve të ujësjellësit, kanalizimit dhe të furnizimit të ujit të përpunuar dhe të papërpunuar me shumicë në Kosovë.

3.1. Vizioni/Misioni

Vizioni:

“Shërbime cilësore, të sigurta dhe efçente të shërbimeve të ujit, për të gjithë konsumatorët në Kosovë”

Misioni:

“Rregullimi i shërbimeve të ujit në mënyrë efektive dhe transparente në pajtim me praktikën e mira Evropiane të cilat sigurojnë që ofruesit e shërbimeve të ujit të japin shërbime kualitative, të qëndrueshme dhe me çmime të përballueshme në tërë Kosovën, duke pasur parasysh ruajtjen e mjedisit dhe mbrojtjen e shëndetit Publik”

3.2. Kompetencat e ARRU, sipas Ligjit

Bazuar në kornizën ligjore aktuale, si institucion përgjegjës për rregullimin e veprimtarive të të gjithë ofruesëve të shërbimeve ka kompetenca për:

- Licencimin e ofruesve të shërbimeve dhe mbikëqyrjen e zbatimit të kushteve të përcaktuara me licencë të shërbimit;
- Përcaktimin e tarifave të shërbimit për ofruesit e shërbimeve, duke siguruar që tarifat të jenë të drejta, të arsyeshme dhe të mundësojnë qëndrueshmëri financiare të ofruesve të shërbimeve;
- Vendosjen e standardeve të shërbimit dhe mbikëqyrjen e zbatimit nga ofruesit e shërbimeve të këtyre standardeve;
- Monitorimin e performancës së ofruesve të shërbimeve për të vlerësuar nëse ata i përmbushin kushtet e përcaktuara me licencën e shërbimit, si dhe caqet e përcaktuara me procesin tarifor;
- Themelimin dhe mbështetjen e Komisioneve Këshilluese të Konsumatorëve në shtatë regionet e Kosovës;
- Hartimin dhe miratimin e rregulloreve, standardeve dhe vendimeve rregullatore në pajtim me autorizimet që ka në bazë të Ligjit Nr.05/L-042 dhe ligjeve tjera të aplikueshme;
- Inspektimin e standardeve të shërbimit dhe mbikëqyrjen e zbatimit të akteve ligjore të Autoritetit.

Në vijim janë përshkruar përgjegjësitë kryesore të njësive organizative të ARRU, funksionimi i të cilave mundëson përmbushjen e kompetencave të cekura më lart dhe detyrave tjera të përcaktuara me ligj:

Departamenti për çështje ligjore dhe licencim: siguron mbështetjen ligjore. Ky departament gjatë përgatitjes së akteve ligjore dhe nën-ligjore përveç që bazohet në ligjet e Republikës së Kosovës, si pikë reference ka edhe direktivat dhe rregulloret e Unionit Evropian. Gjithashtu menaxhon procesin e licencimit të ofruesëve të shërbimeve të ujit përfshirë edhe vlerësimin, në baza të rregullta, të përmbushjes së kushteve të licencimit, si dhe propozimin e masave për përmirësim. Departamenti poashtu ofron ndihmë profesionale dhe monitoron punën e Komisioneve Këshilluese të Konsumatorëve.

Departamenti për tarifa: siguron mbështetje në procesin e përcaktimit të tarifave për ofruesit e licencuar të shërbimeve të ujit. Ky proces përfshin caktimin e caqeve të arritshme dhe sfiduese për të përmirësuar cilësinë e shërbimeve të ofruara. Përmes këtij procesi, departamenti siguron gjetjen e bilancit në mes të mbrojtjes së interesit të konsumatorëve dhe rritjes së qëndrueshmërisë financiare të ofruesve të licencuar të shërbimeve të ujit. Ky departament siguron, në baza të rregullta, vlerësimin e përmbushjes së caqeve dhe propozimin e masave për përmirësim.

Departamenti për raportim të performancës: siguron mbështetje në aktivitetin e raportimit të përmbushjes së caqeve tarifore. Ky departament bën grumbullimin dhe auditimin e saktësisë së të dhënave të raportuara nga ofruesit e shërbimeve të ujit në lidhje me caqet tarifore, përpunimin e këtyre të dhënave në tregues, si dhe interpretimin e tyre.

Departamenti për administratë dhe financa: siguron mbështetje administrative. Ky departament mbështet udhëheqjen e Autoritetit për një funksionim normal të departamenteve duke menaxhuar burimet njerëzore, buxhetin dhe financat e Autoritetit, aktivitetet ndihmëse, si dhe koordinimin e furnizimit dhe mirëmbajtjes së pasurisë së Autoritetit.

Njësia për inspektim: siguron mbështetje në aktivitetin e inspektimit në përgjithësi dhe raportimin dhe inspektimin e përmbushjes së standardeve të shërbimeve nga ofruesit e shërbimeve të ujit në veçanti. Qëllimi i inspektimit është të verifikojë se ofruesit e shërbimeve i kryejnë aktivitetet e tyre në pajtim me legjislacionin aktual. Procesi i inspektimit përfshin grumbullimin, inspektimin në vend-ndodhje, përpunimin e të dhënave në tregues, si dhe interpretimin e tyre.

4. FUSHËVEPRIMI I AUTORITETIT RREGULLATOR PËR SHËRBIMET E UJIT

Fushëveprimi i Autoriteti rregullator për shërbimet e ujit përfshin ndërmarrjet publike të cilat ofrojnë shërbime të ujësjellësit, ujërave të ndotura dhe furnizim të ujit me shumicë.

Në vijim janë paraqitur ndërmarrjet e licencuara nga ARRU të cilat ofrojnë shërbime të ujësjellësit, ujërave të ndotura dhe furnizim të ujit me shumicë të cilat veprojnë në Kosovë, rregullimin ekonomik të të cilave e bën ARRU.

Ripërtëritja e licencave për këto ndërmarrje është bërë nga ARRU me datën 31.05.2016, në pajtim me kornizën ligjore të përcaktuar me Ligjin Nr. 05/L-042, si dhe me procedurat dhe rregullat e përcaktuara me legjislacionin sekondar, në kohëzgjatje prej 3 (tri) vitesh.

Aktualisht të gjitha ndërmarrjet në vijim janë të licencuara deri me 10.09.2018.

(i) Kompanitë e licencuara për shërbimet e ujësjellësit dhe ujërave të ndotura (Ofruesit e licencuar të shërbimeve të ujit):

- KRU “Prishtina” Sh. A., që ofron shërbimet në komunat: Prishtinë, Fushë Kosovë, Obiliq, Podujevë, Lipjan, Shtime, Drenas dhe Graçanicë;
- KRU “Hidroregjioni Jugor” Sh.A, që ofron shërbimet në komunat: Prizren, Malishevë, Suharekë Dragash dhe Mamushë;¹
- KRU “Hidrodrini” Sh.A., që ofron shërbimet në komunat: Pejë, Istog, Klinë, Junik dhe Deçan;
- KRU “Mitrovica” Sh.A., që ofron shërbimet në komunat: Mitrovicë, Skenderaj dhe Vushtrri;
- KRU “Gjakova” Sh.A., që ofron shërbimet në komunat: Gjakovë, Rahovec dhe disa fshatra të Prizrenit;
- KRU “Hidromorava” Sh.A., që ofron shërbimet në komunat: Gjilan, Kamenicë dhe Viti;
- KRU “Bifurkacioni” Sh.A., që ofron shërbimet në komunën: Ferizaj dhe Kaçanik.

Ndërmarrjet publike të ujësjellësit dhe kanalizimit që kanë ekzistuar në komunat me popullatë shumicë serbe (Mitrovicë e Veriut, Laposaviq, Zubin Potok dhe Zveçan) kanë mbetur jashtë proceseve të ristrukturimit dhe korporatizimit dhe rrjedhimisht kanë mbetur jashtë procesit rregullator të cilin aktualisht e zbaton ARRU.

Komunat Shtërpce, Novo Bërdo, Partesh, Kllokot, Ranillug dhe Hani i Elezit planifikohet të integrohen në kompanitë rajonale përkatëse, pas rehabilitimit të infrastrukturës së tyre.

¹ Edhe pse në zonën e shërbimit të KRU “Hidroregjioni Jugor”, për arsye të mungesës së kapacitetit të ujit, konsumatorët e komunës së Mamushës aktualisht nuk marrin shërbime të ujësjellësit nga kjo kompani.

Rehabilitimi është planifikuar përmes investimeve të fazës së V-të të projektit të SDC (investim i Qeverisë Zvicerane). Marrëveshjet me komunat përkatëse janë nënshkruar dhe integrimi do të bëhet pas pranimit teknik të punëve. Sipas donatorëve punët do të përfundojnë në fund të gjashtë mujorit të parë të viti 2018.

Në Mitrovicën veriore vazhdon të operojë pa licencë ofruesi i shërbimeve NPK "Vodovod Ibar". ARRU në vazhdimësi ka bërë përpjekje për zgjidhjen e këtij problemi, bazuar në autoritetin e dhënë me ligj (Ligji nr. 05/L-042, neni 4.3.1) përmes procedimit të letrave dhe paralajmërimeve. Meqenëse nuk kemi pasur asnjë përgjegje pozitive, përkundër që shkresat janë kthyer me arsyetimin e refuzimit të pranimit, në pajtim me Ligjin Nr.05/L-042, ARRU ka inicuar procedurë gjyqësore me datë 30 shtator 2014 - akoma jemi në pritje të vendimit të gjykatës.

(ii) Kompania e Licencuar për Furnizim të Ujit me Shumicë

Kompania e vetme e licencuar që ofron ujë me shumicë është:

- **"Ibër-Lepenci" Sh.A.** e cila furnizon ujë me shumicë për KRU "Mitrovica" Sh.A. dhe KRU "Prishtina" Sh.A.


Zonat e Shërbimeve të Kompanive të Ujësjellësit dhe Kanalizimit



KRU Prishtina	KRU Hidroregjioni Jugor	KRU Hidrodrini	KRU Mitrovica	KRU Gjakova	KRU Bifurkacioni	KRU Hidromorava	Komunat jashtë shërbimeve nga KRU-të
Prishtina Podujeva Fushë Kosova Obiliçi Lipjani Drenasi Shtime Graçanica	Prizreni Suhareka Malisheva Dragashi Mamusha	Peja Istogu Klina Juniku Deçani	Mitrovica Skenderaj Vushtrria	Gjakova Rahoveci Prizren (disa fshatra)	Ferizaj Kaçaniku	Gjilani Kamenica Vitia	Novobërda Zubin Potoku Leposaviçi Zveçani Shtërpce, Hani i Elezit, Partesh, Rani Ilug, Mitrovica e Veriut, Kllokot

4.1 Organizimi i brendshëm i Autoritetit rregullator për shërbimet e ujit

ARRU aktivitetet e veta i përmbush sipas organizimit të paraqitur në organogram



4.2. Bordi

Autoriteti rregullator për shërbime të ujit, sipas Ligjit Nr.05/L-042 nuk ka Bord.

4.3. Ekzekutivi

a) Drejtori dhe Zëvendës Drejtori i ARRU

Drejtori i ARRU është përgjegjës për: administrimin, menaxhimin dhe organizimin e ARRU, punësimin e personelit, nxjerrjen e udhëzimeve administrative, menaxhimin e resurseve dhe buxhetit të ARRU, përfaqësimin e institucionit brenda dhe jashtë vendit si dhe detyrat tjera të përcaktuara me ligjin Nr. 05/L-042.

Zëvendës drejtori i ARRU: ndihmon drejtorin në kryerjen e detyrave të tij. Në mungesë të drejtorit, ARRU udhëhiqet nga zëvendësdrejtori.

b) Menaxhmenti i mesëm i ARRU

Menaxhmenti i mesëm përbëhet nga kryesuesit/udhëheqësit e njësive organizative të ARRU të cilët janë përgjegjës për organizimin dhe udhëheqjen e njësive organizative përkatëse, bashkëpunim me njësitë tjera organizative të ARRU, këshillojnë drejtorin lidhur me temat specifike të njësive organizative përkatëse si dhe detyrat tjera të përcaktuara me Rregulloren 03-OB/2016.

c) Mandati

Drejtori dhe Zëvendës Drejtori i ARRU zgjidhen nga Kuvendi i Republikës së Kosovës me mandat pesë (5) vjeçar.

- Drejtori është zgjedhur me 28 prill 2016 dhe ka mandat deri me 28 prill 2021,
- Zëvendës Drejtori është zgjedhur me 28 tetor 2016 dhe ka mandat deri me 28 tetor 2021.

4.4. Burimet Njerëzore

a) Numri i përgjithshëm i punëtorëve në ARRU është nëntëmbëdhjetë (19)

b) Në bazë të ligjit të buxhetit të aprovuara janë 21 pozita, porse në vitin 2017 për 2 pozita nuk ka pasur buxhet. Presim kompletimin e stafit gjatë vitit 2018.

c) Me qëllim të ngritjes profesionale, si çdo vit edhe për vitin 2017 është përgatitur plani vjetor i trajnimeve për periudhën Janar 2016 – Dhjetor 2016 për të punësuarit e ARRU.

Edhe pse për çdo vit Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit bën planifikimet e trajnimeve për personelin e vet dhe e dorëzon në Ministrinë e Administratës Publike, asnjë trajnim nuk është realizuar sepse MAP nuk organizon trajnime për të cilat ka nevojë personeli i ARRU-së.

4.5. Asetet

Duke pasur parasysh ligjet e zbatueshme në Kosovë mbi themelimin e institucioneve të Kosovës, Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës, si dhe Rregulloret e Thesarit, institucionet

buxhetore vetë e bëjnë regjistrimin e aseteve ndërsa amortizimin e tyre mbi vlerën 1000€ e bën departamenti i thesarit.

Vlera e aseteve të përgjithshme pas regjistrimit dhe vlerësimit për vitin 2017 në ARRU është 20,873.34€

Asetet mbi 1000€ janë 1,329.00€ ndërsa asetet nën 1000€ janë 19,544.34€

Asetet e ARRU janë mjetet e punës përmes të cilave i përmbushim obligimet tona. Në këto mjete bëjnë pjesë: vetura (5), kompjuterë, laptopë, printerë, fotokopje, server, tavolina, karrige.

ARRU që nga data 01 prill 2017 është transferuar në objektin privat në Rr. Ali Pashë Tepelena Nr.1, objekt me hapësirë më të madhe dhe me afër institucioneve të Kosovës. Çmimi për qiranë e këtij objekti është i njëjtë me çmimin të cilin e kemi pasur në objektin paraprak.

5. AKTIVITETET PËR PERIUDHËN RAPORTUESE

ARRU ka obligim ligjor dhe detyrë që përmes aktiviteteve të veta dhe autoritetit të dhënë me ligj të sigurojë se ofruesit e licencuar të shërbimeve zbatojnë Ligjin dhe Rregulloret në fuqi, me qëllim të sigurimit të mbrojtjes së konsumatorëve, transparencës në punë dhe stimulimin e konkurrencës mes tyre. Përbushja e këtyre obligimeve edhe gjatë vitit 2017 është arritur përmes aktiviteteve dhe detyrave të parapara në Planin Strategjik dhe në Planin Vjetor të Punës së ARRU.

Në vijim janë paraqitur aktivitetet, procedurat dhe rezultatet e aktiviteteve të ARRU për periudhën raportuese (vitin 2017). Gjithashtu për ti dhënë lexuesit të këtij Raporti një pasqyrim të përgjithshëm të gjendjes së sektorit të ujit në Kosovë përmes disa treguesve kyç të performancës janë paraqitur rezultatet e ofruesve të shërbimeve në përbushjen e caceve të përcaktuara nga ARRU, si dhe performanca e tyre.

5.1. Amandamenti i Ligjit Nr. 05/L - 042

Me rekomandim të Komisionit për bujqësi, pylltari, zhvillim rural, mjedis dhe planifikim hapësinor të Kuvendit të Republikës së Kosovës, është iniciuar Plotësim Ndryshimi i Ligjit për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit. Plotësim ndryshimi i Ligjit është iniciuar për arsye të vështirësive ligjore të cilat janë krijuar me miratimin e Ligjit për kundërvajtje Nr.05/L-087, si dhe shqetësimeve tjera të ngritura nga ofruesit e shërbimeve.

5.2. Rrishqyrtimi i Rregullores Nr.02/2016 për Standardet Minimale të Shërbimeve të Ujit në Kosovë

Bazuar në paragrafin 3 të nenit 21 të ligjit Nr. 05/L - 042, ARRU ka iniciuar rishqyrtimin e Rregullores Nr.02/2016 për Standardet Minimale të Shërbimeve të Ujit në Kosovë. Meqenëse nuk kemi pasur propozime për ndryshim nga ofruesit e shërbimeve, e njëjta ka vazhduar të mbetet në fuqi.

5.3. Shqyrtimi dhe aprovimi i akteve internet të ofruesve të shërbimeve

Në pajtim me nenin 48 të ligjit Nr.05/L-042, gjatë vitit 2016, ARRU ka shqyrtuar dhe aprovuar nga pesë (5) Rregullore për shtatë (7) ofrues të licencuar të shërbimeve- gjithsejt 35 Rregullore. Rregulloret e shqyrtuara dhe të aprovuara janë:

- R01/2017 Rregullorja për zgjidhjen e ankesave të konsumatorëve;
- R02/2017 Rregullorja për procedurat e lidhjes së konsumatorëve në shërbimet e ujit;
- R03/2017 Rregullorja për procedurat e ndërprerjes së shërbimeve të ujit;
- R04/2017 Rregullorja për procedurat e faturimit për shërbimet e ujit;
- R05/2017 Rregullorja për matjen e konsumit të ujit.

5.4. Përcaktimi i tarifave për vitin 2018-2020

Duke qenë se viti 2017 ka shënuar vitin e fundit të procesit tarifar 2015-2017, një ndër angazhimet kryesore të ARRU gjatë këtij viti ka qenë shqyrtimi i aplikacioneve të ofruesve të shërbimeve për tarifa dhe përcaktimi i tarifave për periudhën e ardhshme tri vjeçare - *Procesi Tarifar 2018 - 2020*.

Gjatë shqyrtimit të aplikacioneve të ofruesëve të shërbimeve për tarifa i jemi përmbajtur parimit për të balancuar interesat e konsumatorëve me nevojën për të ruajtur integritetin financiar të ofruesve të shërbimeve.

5.4.1. Përcaktimi i tarifave për shërbimet e ujit

Tarifat për periudhën 2018 - 2020 janë përcaktuar nga të dhënat e Biznes Planeve Rregullatore të deklaruara nga ofruesit e shërbimeve, të cilat janë akorduar dhe aprovuar nga ARRU pas analizave, vlerësimeve dhe konsultave reciproke.

Është detyrë e jona të sigurojmë që ofruesit e shërbimeve të operojnë në mënyrën sa më eficiente të mundshme që të sigurohemi se konsumatorët nuk paguajnë më shumë se që është e nevojshme, prandaj gjatë përcaktimit të caqeve kemi pasur parasysh që ato të jenë sfiduese por megjithatë realiste.

Caqet në të cilat i kemi sfiduar ofruesit e shërbimeve gjatë shqyrtimit të aplikacioneve (biznes planeve) i përkasin fushave të cilat kanë ndikim të drejtpërdrejt në tarifa siç janë:

- *Shpenzimet operative* - i kemi nxitur ofruesit e shërbimeve që të zvogëlojnë shpenzimet e tyre operative.
- *Shkalla e humbjeve* - me fokus në humbjet komerciale (kyçjet e paligjshme dhe aktivitetet e dobëta të faturimit), janë sfiduar ofruesit e shërbimeve në reduktimin e sasisë së ujit të humbur nga dy përqind vit pas viti, për vitet 2018, 2019 dhe 2020.
- *Shkalla e arkëtimit* - kemi përcaktuar përmirësimin e shkallës së arkëtimit duke planifikuar 100 % arkëtim për konsumatorët joshtëpiak dhe përmirësim të shkallës së arkëtimit të konsumatorët shtëpiak nga 3% vit pas viti për tri vitet e procesit tarifar 2018-2020.

Përmbushja e caqeve të përcaktuara do të jetë objekt analize dhe vlerësimi në Raportin Vjetor të vitit 2018.

Tarifa përcaktohet nga kërkesa për të ardhura e që i plotëson kushtet e mësipërme, pjesëtuar me vëllimin e ujit të shitur (përshtatur për eficiencën në arkëtimin e të ardhurave). Kërkesa për të ardhura është e përbërë nga tri komponente kryesore:

- Shpenzimet operative;
- Mirëmbajtja kapitale e përbërë nga:
 - Përtëritjet infrastrukturore (financimi i domosdoshëm për të ruajtur shërbyeshmërinë e aseteve infrastrukturore / nëntokësore), dhe
 - Zhvlerësimi sipas kostos aktuale për asetet jo-infrastrukturore (kryesisht ato mbi tokësore).
- Kthimi në Bazën Rregullatore të Aseteve.

Nga obligimet rregullatore të procesit rregullatorë të tarifave të periudhës tarifore 2018-2020, fillimisht është aplikuar tarifa për aplikim për vitin 2018, me mundësi rishikimi të jashtëzakonshëm dhe të rregullt të tarifave të vitit 2019 dhe më pastaj edhe ato të vitit 2020, të cilave u ka paraprirë procedura e njëjtë.

Baza e rishikimit të tarifave për faturim të konsumatorëve të shërbyer janë; shkalla e përmbushjes së caqeve të përcaktuara të procesit rregullatorë të tarifave, për vitet përkatëse paraprake dhe aktuale; shkalla e realizimit të investimeve kapitale gjatë periudhës së shikuar për çdo kompani veç e veç dhe për sektorin si tërësi; shkalla e lëvizjeve inflatore dhe gjendja socio-ekonomike në vend.

Lëvizjet inflatore monitorohen nga publikimet e bëra të Agjencisë së Statistikave të Kosovës për periudha të caktuara të lëvizjes së Indeksit të Çmimeve të Konsumit në Kosovë.

Tarifat fikse (€/muaj) për konsumatorët shtëpiakë për shërbimet publike të ujit kanë mbet të njëjta që nga fillimi i përcaktimit të tyre 2005-2006, dhe do të ngarkohen muaj për muaj me nga 1.00 €/muaj, ndërsa konsumatorë jo-shtëpiak duke filluar nga viti 2018 do të ngarkohen me nga 2.00 €/muaj për dallim prej 3.00€/muaj sa kanë paguar deri më tani.

Në tabelën e mëposhtme paraqesim tarifat volumetrike të shërbimeve publike për furnizim me ujë, të shërbimeve të ujërave të ndotura të aplikuara gjatë periudhës së përmbyllur tarifore 2014- 2017, si dhe tarifat e aplikueshme për vitin 2018 për çdo kompani veç e veç dhe tarifat mesatare të sektorit në nivel të vendit. Duhet pasur parasysh se tarifat gjatë tri viteve të fundit nuk kanë pësuar rritje kurse gjatë vitit 2018 tarifat volumetrike kumulative (për ujë dhe ujëra të ndotura) për konsumatorët shtëpiak në nivel të sektorit janë rritur për një cent (nga 42 cent në 43 cent), kurse tarifat kumulative (për ujë dhe ujëra të ndotura) për konsumatorët Institucional dhe Komercial janë ulur për dy cent (nga 88 cent në 86 cent) si pasoj e reduktimit të shkallës së ndër subvencionimit në mes të konsumatorëve shtëpiak dhe konsumatorëve jo shtëpiak.

Tabela nr. 1. Tarifat komulative volumetrike për shërbimet e ujit për të dy grupimet e konsumatorëve 2014-2018

Kompania	Grupimi i konsumat orëve	Njësia matëse	Tarifat e aplikuara gjatë vitit 2014	Tarifat e aplikuara gjatë vitit 2015	Tarifat e aplikuara gjatë vitit 2016	Tarifat e aplikuara gjatë vitit 2017	Tarifat për aplikim gjatë vitit 2018
KRU Prishtina	Shtëpiak	€/m ³	0.43	0.44	0.44	0.44	0.47
	Jo-shtëpiak	€/m ³	0.98	0.99	0.99	0.99	0.96
KRU Hidroregjioni Jugor	Shtëpiak	€/m ³	0.41	0.42	0.42	0.42	0.44
	Jo-shtëpiak	€/m ³	0.79	0.80	0.80	0.80	0.83
KRU Hidrodrini	Shtëpiak	€/m ³	0.29	0.30	0.30	0.30	0.32
	Jo-shtëpiak	€/m ³	0.60	0.61	0.61	0.61	0.61
KRU Mitrovica	Shtëpiak	€/m ³	0.45	0.45	0.45	0.45	0.45
	Jo-shtëpiak	€/m ³	0.96	0.96	0.96	0.96	0.91
KRU Gjakova	Shtëpiak	€/m ³	0.44	0.45	0.45	0.45	0.47
	Jo-shtëpiak	€/m ³	0.92	0.93	0.93	0.93	0.90
KRU Bifurkacioni	Shtëpiak	€/m ³	0.45	0.46	0.46	0.46	0.47
	Jo-shtëpiak	€/m ³	0.97	0.98	0.98	0.98	0.96
KRU Hidromorava	Shtëpiak	€/m ³	0.41	0.41	0.41	0.41	0.42
	Jo-shtëpiak	€/m ³	0.85	0.85	0.85	0.85	0.86
SEKTORI	Shtëpiak	€/m ³	0.41	0.42	0.42	0.42	0.43
	Jo-shtëpiak	€/m ³	0.87	0.88	0.88	0.88	0.86

Tarifat e kësaj pasqyre tarifore janë pa TVSH.

Tarifat e periudhës së rregullt tarifore 2018-2020 janë përcaktuar sipas nivelit të kostove të 6 mujorit të parë të vitit 2017 dhe të dhënave të tjera të planifikuara për 6 mujorin e dytë të të njëjtit vit dhe të dhënave të tjera të planifikuara për periudhën 2018-2020.

Në tabelën Nr.02 për ilustrim dhe krahasim janë paraqitur tarifat volumetrike të disa vendeve të Rajonit.

Tabela nr. 2. Tarifat komulative volumetrike në disa vende të rajonit

Nr	Shteti	Qyteti	Konsumatorët	Tarifa volumetrike për ujë dhe kanalizim €/m ³
1	Kosovë	Mesatarja	Shtëpiak	0.43
			Jo shtëpiak	0.86
2	Shqipëri	Tiranë	Shtëpiak	0.57
			Jo shtëpiak	1.28
2	Shqipëri	Durrës	Shtëpiak	0.90
			Jo shtëpiak	1.35
3	Maqedoni	Shkup	Shtëpiak	0.48
			Jo shtëpiak	1.07
4	Mali i Zi	Herceg Novi	Shtëpiak	1.05
			Jo shtëpiak	2.16
5	Serbi	Novi Sad	Shtëpiak	0.62
			Jo shtëpiak	1.45
6	Bosnja dhe Hercegovina	Sarajevë	Shtëpiak	0.61
			Jo shtëpiak	0.85
7	Kroacia	Osijek	Shtëpiak	0.84
			Jo shtëpiak	1.31

Tarifat e paraqitura në tabelë janë pa TVSH.

Për të paraqitur çmimet në euro kursi valutor është marrë nga ueb faqja e

Bankës Qendrore të Kosovës (BQK) me date 13.02.2018

5.4.2. Përcaktimi i tarifave për shërbimet e ujit me shumicë

- **Tarifat për NHE “Iber Lepenc”** me të cilat faturohen KRU Mitrovica dhe KRU Prishtina llogariten në bazë të largësisë respektivisht gjatësisë së kanalit dhe sasisë së ujit të liferuar. Nga tabela e mëposhtme, mund të vëreni se këto tarifa për KRU Mitrovica dhe për KRU Prishtina gjatë vitit 2018 janë më të ulta se tarifat e vitit 2017 për arsye të rritjes së sasisë së ujit si nga KRU Mitrovica po ashtu edhe nga KRU Prishtina.

Tabela nr. 3 Tarifat e NHE Iber Lepenci për vitin 2017

Furnizuesit e ujit me shumicë	2017	2018
Furnizimi nga “Iber-Lepenci” Prishtinë, - KRU “Mitrovica” sh. a. Mitrovicë	0.0184	0.0163
Furnizimi nga “Iber-Lepenci” Prishtinë, - KRU Prishtina” sh. a. Prishtinë	0.0455	0.0364
Furnizimi nga KRU “Mitrovica” sh. a. Mitrovicë për Mitrovicën e Veriut	0.17	0.17

Tarifat e paraqitura në tabelën nr. 3 janë pa TVSH.

- **Tarifat për Mitrovicën e Veriut** - Baza për llogaritjen e Tarifave të ujit me shumicë të përpunuar me të cilin KRU 'Mitrovica' furnizon pjesën veriore është sasia e ujit e planifikuar për furnizim si dhe shpenzimet që lidhen me sasinë e cila dërgohet në pjesën veriore. Tarifa për m^3 për pjesën veriore është 0.17 euro (shtatëmbëdhjetë cent) krahasuar me tarifën prej 0.36 euro (tridhjetë e gjashtë cent), për m^3 për konsumatorë shtëpiak të pjesës jugore. Për të arsyetuar këtë tarifë, ARRU bazohet në Udhëzimet e Kontabilitetit Rregullator (UKRR) ku janë të ndara kosto qendrat e shërbimeve të ujësjellësit. Sipas UKRR janë tri kosto qendra: (1) Resurset dhe Trajtimi i Ujit, (2) Distribrimi i ujit dhe (3) Aktivitetet Biznesore. Duke qenë në dijeni që KRU "Mitrovica" nuk operon në pjesën veriore të qytetit, uji i distribuuar për atë pjesë nga Fabrika e Përpunimit të Ujit në Shipol, nga pjesa jugore e qytetit përmes katër daljeve u dërgohet pjesës veriore.

Shpenzimet që lidhen me Fabrikën për Përpunimin e Ujit (FPU) ndahen në raport me sasinë e ujit të faturuar për pjesën jugore dhe pjesën veriore.

Shpenzimet për distribuim të ujit kanë pjesëmarrje më të vogël për pjesën veriore pasi që shpenzimet e mirëmbajtjes së rrjetit, si dhe investimet në përtëritjen e rrjetit të ujit, nuk janë përgjegjësi e KRU 'Mitrovica' por e Komunës së veriut për shkak se kompania nuk ka qasje në këtë pjesë.

Shpenzimet e Aktiviteteve Biznesore kanë pjesëmarrje të vogël në koston për pjesën veriore, pasi që për këtë pjesë lëshohen vetëm katër fatura mujore, kurse numri i faturave për pjesën jugore është gati 30.000 fatura për çdo muaj. Këtu kemi parasysh edhe shpenzimet që lidhen me kujdesin ndaj konsumatorëve për pjesën jugore, kurse për pjesën veriore nuk ka shpenzime të natyrës së tillë.

Duke pasur parasysh shpenzimet totale që gjeneron KRU "Mitrovica", si dhe alokimin e mësipërm të shpenzimeve operative, kur këto futen në raport me sasinë e ujit të dërguar për pjesën veriore të qytetit, kjo paraqet edhe bazën e kalkulimit të tarifës në $\text{€}/m^3$.

Duhet theksuar se procesi i përcaktimit të Tarifave për ujin me shumicë të përpunuar për pjesën veriore është proces i ndarë me procesin e përcaktimit të tarifave të ujit për konsumatorët e Regjionit të Mitrovicës. Konsumatorët e pjesës jugore nuk paguajnë faturat për pjesën veriore respektivisht nuk kanë tarifa më të larta si pasojë e mos pagesës nga qytetarët e pjesës veriore.

Faturat për pjesën veriore nuk i pranon askush edhe pse me Urdhëresën Tarifore të Shërbimit për Ujin me shumicë të përpunuar në pikën gjashtë (6), theksohet se KRU Mitrovica duhet të lidhë kontratë me autoritetet e pjesës veriore për furnizim me ujë të pijes me shumicë.

5.4.3. Politikat tarifore

Përbrenda kornizës së përgjithshme të procesit për përcaktimin e tarifave, gjatë vitit 2017 janë hartuar Politikat Tarifore për Shërbimet e Furnizimit me ujë dhe Shërbime të ujërave të zeza. Parimet kryesore që përfshihen në këtë dokument janë:

- Për secilën KRU tarifrat duhet të jenë uniforme përgjatë tërë zonës së saj së shërbimit dhe për secilin grup të konsumatorëve. Ky dokument i Politikave Tarifore zëvendëson dokumentin e mëhershëm 'Politikat Tarifore për Furnizim me Ujë', të vitit 2011 me vetëm disa ndryshime minimale. Politikat tarifore mund të gjenden në: http://www.arru-rks.org/assets/cms/uploads/files/Tarifat/Drafti_final_9_Politikat_tarifore_16_03_2011.pdf
- Ndër-subvencionimi ekzistues nga konsumatorët jo-shtëpiak te ata shtëpiak për shërbimet e furnizimit me ujë duhet që gradualisht me kalimin e kohës të reduktohen.
- Sa i përket shërbimeve për ujëra të zeza dallimi ekzistues në mes të tarifave të konsumatorëve jo-shtëpiak dhe atyre shtëpiak duhet të ekzistojnë pasi që konsumatorët jo-shtëpiak gjenerojnë më shumë ndotje të ujërave se konsumatorët shtëpiak.
- Tarifrat duhet të jenë të mjaftueshme për të mirëmbajtur shërbyeshmërinë e aseteve dhe të financojnë investimet.
- KRU duhet t'u takojë të fitojnë kthimin në bazën rregullatore të aseteve të tyre në atë masë që të financojnë investimet kapitale në sektor.

5.5. Monitorimi i përmbushjes së caqeve (objektivave)

Përmes këtij aktiviteti monitorohet përmbushja e caqeve të cilat përcaktohen dhe aprovohen nga ARRU përmes procesit tarifor. Përmbushja apo mospërmbushja e këtyre caqeve është një ndër faktorët determinues për përcaktimin e tarifave të vitit pasues.

Procedurat e monitorimit kryhen nga analizimi i të dhënave për përmbushje apo mospërmbushje të caqeve të aprovuara, të treguesve kryesor, të cilët janë të njëjtë për analizimin e të gjitha kompanive.

Të dhënat sigurohen nga raportimet në baza mujore dhe raportet vjetore të KRU-ve, të cilat si plotësisht të vlefshme llogariten pasi të ketë përfunduar procesi i analizimit dhe auditimit nga stafi profesional i ARRU.

Pasqyra e plotë e afarizmit të të gjitha KRU-ve dhe sektorit do të dihen me përmbylljen e librave financiare të vitit 2017, të cilat duhet të kompletohen gjer në fund të Marsit të vitit 2018.

Të dhënat e shfrytëzuara për analizën e përmbushjes së caqeve për vitin 2017 janë të dhëna të pa audituara (meqenëse pasqyrat financiare ende nuk janë përmbyllur) ndërsa të dhënat e vitit 2016 janë të verifikuara me procesin e auditimit. Të dhënat e vitit 2017 do të saktësohen pas përmbylljes së fazës së auditimit.

Në vijim të këtij raporti, përmes tabelave dhe shpjegimeve është paraqitur shkalla e përmbushjes së caqeve të aprovuara nga ARRU të disa prej treguesve kryesor në nivel të

sektorit nga ana e ofrueve të shërbimeve gjatë vitit 2016. Për të dhëna të plota mund të shikoni: <http://www.arru-rks.org>. *Tarifat, Raportet, Raport mbi Vlerësimin e Përbushjes së Caqeve për periudha të caktuara të vitit 2017 nga procesi rregullatorë i tarifave të periudhës 2015-2017.*

Të dhënat janë paraqitur në formë tabelare, ku janë pasqyruar të dhënat e vitit 2016 (për krahasim), të dhënat e aprovuara nga ARRU për vitin 2017, të dhënat e realizuara gjatë vitit 2017, përqindja e përbushjes/mospërbushjes së caqeve dhe vlerësimi përfundimtar.

5.5.1 Përbushja e caqeve operative - prodhimi i ujit, uji i pafaturuar, uji dhe ujërat e ndotura të faturuara, numri i konsumatorëve

Për analizën e të dhënave operative kemi marrë parasysh të dhënat sasiore për metër kub (m³): (I) uji i prodhuar, (II) uji i humbur apo i pa faturuar, (III) uji i faturuar, (IV) ujërat e ndotura të faturuara; (V) numri i konsumatorëve.

Tabela Nr. 4. Pasqyra e të dhënave historike sasiore për ujin e prodhuar, ujin e humbur, ujin e faturuar dhe numrin e konsumatorëve të shërbyer gjatë vitit 2016, krahasuar me të dhënat e aprovuara dhe realizuara për vitin 2017 me të cilat vlerësohet shkalla e përbushjes së caqeve të periudhës së përcaktuar me vlerësimin e DFTRR/ARRU për sektorin

Te dhënat për shërbimet e sektorit të ujit	Njësia matëse	Historiku i realizuar. 2016	Aprovuar për vitin 2017	Realizuar për vitin 2017	Ndryshimi ne % (5/4)	Vlerësomi
1	2	3	4	5	6	7
Uji i prodhuar	m ³	143,736,575	148,157,090	154,255,908	104%	R
Uji i humbur	m ³	81,662,581	74,927,401	89,558,999	120%	Jo e R
Uji i faturuar	m ³	62,073,994	73,229,689	64,696,909	88%	Jo e R
Konsumatorët	numër	327,285	342,303	338,825	99%	R

Sqarimi i shkurtesave për vlerësimin: Jo e R = Jo e realizuar- vlerësim negativ, R = Realizuar- vlerësim pozitiv.

Të dhënat sektoriale të lartë cekura pasqyrojnë shkallën e realizimit dhe mos realizimit të objekteve për grupimin e parë të katër treguesit bazik të përcaktuar për vitin biznesor 2017.

Kur shikohen të dhënat sektoriale mund të konstatohet se sasia e ujit të humbur dhe ajo e faturuar nuk janë realizuar dhe performanca e tyre vlerësohet negativisht, ndërsa sasia e ujit të prodhuar edhe pse në shikim të parë është e realizuar del të jetë negative për shkak të humbjeve të shtuara të ujit dhe mos faturimit të sasisë së ujit të aprovuara me BPRR-ën për periudhën e shikuar, ndërsa kemi shtim të konsiderueshëm të numrit të konsumatorëve.

5.5.2. Përbushja e caqeve për shpenzimet operative

Në formë tabelare (tabela Nr.5) janë paraqitur të dhënat sektoriale për shpenzimet operative, duke paraqitur kostot paraprake të shërbimeve të ujit për vitin 2016 dhe ato të aprovuara dhe realizuar gjatë vitit 2017, të cilat na mundësojnë krahasimin e këtyre të dhënave dhe vlerësimin e shkallës së përbushjes së objektivave të përcaktuara për vitin 2017.

Tabela Nr. 5. Pasqyra e të dhënave të shpenzimeve operative gjatë vitit 2016 për tu krahasuar me të dhënat e vitit 2017, me caqet e aprovuara dhe realizuara të vitit 2017, me % krahasimin e të dhënave të aprovuara dhe realizuara për këtë viti dhe me vlerësimin e ARRU

Te dhënat për shërbimet e sektorit të ujit	Njësia monetare.	∑ e shpenzimeve historike për vitin 2016	∑ e shpenzimeve të aprovuar nga ARRU 2017	∑ e shpenzimeve të realizuar nga KRU-të për vitin 2017	% e realizim. të cakt. për vitin 2016 (5/4)	Vlerësimi
1	2	3	4	5	6	7
Shuma e Shpenzimeve operative sektoriale	€	22,662,749	24,738,436	24,261,711	98%	P (Pozitiv)

Siq shifet nga tabela nr. 5, kostot e operimit në nivel të sektorit gjatë vitit 2017 kanë qenë më të ulta se ato të aprovuara për vitin 2017 për 2%, e dhënë kjo e cila tregon një menaxhim të mirë të kostove.

5.5.3. Përbushja e caqeve të faturimit dhe arkëtimit

Në tabelën e më poshtme janë pasqyruar të dhënat sektoriale për faturim dhe arkëtim për vitin 2016 dhe ato të aprovuara dhe realizuara nga sektori për vitin 2017, me % dhe vlerësimin për këto të dhëna.

Tabela Nr. 6. Pasqyra e të dhënave historike të faturimit dhe arkëtimit gjatë vitit 2015, krahasuar me të dhënat e aprovuara dhe realizuara për vitin 2016, me të cilat vlerësohet shkalla sektoriale e përbushjes së caktuar të periudhës së shikuar me vlerësimin e ARRU.

Te dhënat për shërbimet e sektorit të ujit	Njësia monetare	∑ e faturimit dhe arkëtimit për vitin 2016	∑ e faturimit dhe arkëtimit të aprovuar për vitin 2017	∑ e faturimit dhe arkëtimit të aprovuar për vitin 2017	% e faturimit dhe arkëtimit për vitin 2016 (5/4)	Vlerësimi
1	2	3	4	5	6	7
Shuma e faturimit	€	31,713,255	37,754,357	33,461,992	89%	Jo e R (Negativ)
Shuma e arkëtimit	€	27,285,140	30,999,412	27,876,431	90%	Jo e R (Negativ)

Edhe pse kemi rritje të faturimit dhe arkëtimit në euro gjatë vitit 2017 krahasuar me vitin 2016, KRU-të nuk kanë arritur të realizojnë caqet e përcaktuara dhe të aprovuara nga ARRU për vitin 2017.

5.6. Monitorimi i performancës së ofruesve të shërbimit të ujit

Përmes këtij aktiviteti ARRU monitoron performancën e ofruesve të shërbimeve në përbushjen e përgjegjësive të tyre dhe përcillet progresi nga viti në vit i përmirësimit të shërbimeve. Ky aktivitet gjithashtu shërben për nxitjen e konkurrencës (benchmarking) mes ofruesve të shërbimeve.

Arritjet maten në bazë të treguesve kyç të performancës të cilët janë të njëjtë për të gjithë sektorin.

Performanca matet kundrejt mesatares së sektorit, performancës individuale të secilës kompani, si dhe krahasimit të performancës në vitin 2017 në raport me vitin 2016.

Monitorimi i performancës bëhet në bazë të raporteve të cilat ofruesit e shërbimeve i paraqesin në ARRU në baza mujore dhe raportimin vjetor, në pajtim me obligimet raportuese që kanë ndaj ARRU.

Raportet janë përmbledhur në baza mujore përmes sistemit të raportimit financiar, operativ, shërbimeve ndaj konsumatorëve (ROFK), si dhe planit të monitorimit vjetor (PMV), i cili parasheh raportimin vjetor sipas konceptit rregullator. Për këtë qëllim ARRU ka dizajnuar dy (2) formate të raportimit: (i) raporti mujor dhe (ii) raporti vjetor. Këto formate u janë dorëzuar ofruesve të shërbimeve së bashku me udhëzimet përkatëse për mënyrën dhe formën e raportimit.

Sipas raportimeve të kërkuara, është përditësuar në baza të rregullta edhe baza e të dhënave të ARRU e cila përbëhet nga dy programe softuerike ROFK dhe DB vjetore. Të dy programet mundësojnë procedimin e treguesve të performancës në mënyrë automatike, si dhe ofrojnë mundësinë e nxjerrjes së raporteve në forma dhe periudha kohore të ndryshme, varësisht nga kërkesat e caktuara.

Bazuar në këto të dhëna, pas analizave, si dhe verifikimit të tyre përmes procesit të auditimit si çdo vit edhe në vitin 2017 ARRU ka publikuar Raportin Vjetor të Performancës (për vitin 2016) në të cilin pasqyrohet performanca e përgjithshme e sektorit dhe e ofruesve të shërbimeve veç e veç ([http://www.arru-rks.org/assets/cms/uploads/files/Monitorimi iPerformances/RAPORTI I PERFORMANCES 2016.pdf](http://www.arru-rks.org/assets/cms/uploads/files/Monitorimi%20iPerformances/RAPORTI%20I%20PERFORMANCES%202016.pdf))

Me qëllim të avancimit të procesit të vlerësimit të performancës, ARRU në bashkëpunim me palët tjera (projekti mbështetës financiar nga SDC, KNMU, KRU-të) ka përpiluar dokumente/udhëzues. Dokumentet u janë përcjellë të gjithë ofruesve të shërbimeve dhe aplikimi i tyre nga ARRU dhe ofruesit e shërbimeve do të ndikojë në vlerësimin e besueshmërisë së të dhënave gjatë auditimit të të dhënave për vitin 2017.

Dokumentet e përpiluara janë:

- Skema e re e treguesve kyç të performancës,
- Metodologjia për vlerësimin e besueshmërisë së të dhënave të raportuara.

Në vijim, për informimin e lexuesit të këtij raporti, përmes disa prej treguesve kyç të performancës (TKP) është paraqitur performanca e përgjithshme e sektorit dhe performanca individuale për shtatë ofruesit e shërbimeve të cilët janë të licencuar nga ARRU. Me qëllim të paraqitjes së krahasimit të zhvillimit, *në nivel të sektorit* janë paraqitur të dhënat e këtyre treguesve periudhë pesë (5) vjeçare, ndërsa *performanca individuale* është paraqitur përmes krahasimit të zhvillimit në vitin 2017 në raport me vitin 2016.

Të dhënat e paraqitura për vitin 2017, janë të dhëna të pa audituara, pasi pasqyrat financiare të ofruesve të shërbimeve ende nuk janë përmbyllur, ndërsa të dhënat për vitin 2013, 2014, 2015 dhe 2016 janë të dhëna të audituara nga ARRU.

5.6.1. Mbulueshmëria me shërbime të ujit

Mbulueshmëria me shërbime të ujit nënkupton përqindjen e popullatës brenda zonës së shërbimit të ofruesve të licencuar të shërbimeve të cilët ofrojnë shërbime të ujësjellësit dhe ujërave të ndotura.

Në zonën e shërbimeve të ofruesve të shërbimeve, vlerësohet se jetojnë një popullatë prej 1.7mil. banorë, prej të cilëve rreth 1,6 mil. banorë apo 94%, marrin shërbime të ujësjellësit. Pjesa tjetër e popullatës banojnë kryesisht në zonat rurale, të cilat kanë ujësjellës të veçantë apo sisteme individuale, të cilat nuk menaxhohen nga ofruesit e shërbimeve. Qasje në shërbimet e ujërave të ndotura kanë rreth 1.2 mil. banorë apo 74%.


Mbulueshmëria me shërbime	Ujësjellës	Ujëra të ndotura
2013	82%	60%
2014	84%	62%
2015	87%	65%
2016	91%	69%
2017	94%	74%

Tabela nr.7 Norma e mbulueshmërisë me shërbime të ujit për periudhën 2013-2017

Siq edhe shifet në tabelën nr. 7, mbulueshmëria me shërbime të ujësjellësit nga viti 2013-2017, është rritur për 12% nga viti 2013, përdërisa shërbimet e ujërave të ndotura për këtë periudhë janë rritur për rreth 14%.

Numri i përgjithshëm i konsumatorëve të cilët marrin shërbime në nivel të vendit për vitin 2017 është 338,324 konsumatorë me një rritje prej 11,539 konsumatorë krahasuar me vitin paraprak. Në diagramet e mëposhtme Nr.01 dhe Nr.02 është paraqitur performanca individuale e ofruesve të shërbimeve për vitin 2017 (e krahasuar me vitin 2016), lidhur me zhvillimet në aspektin e ofrimit të shërbimeve të ujësjellësit dhe shërbimeve të ujëravë të ndotura.

- a) Mbulueshmëria me shërbime të ujësjellësit është e definuar si përqindja e popullsisë brenda zonës së shërbimit të cilët marrin shërbime të ujësjellësit të ofruara nga ofruesit e licencuar të shërbimeve.



Diagrami nr. 1, mbulueshmëria me shërbimet e ujësjellësit

Mbulueshmëria me shërbimin e furnizimit me ujësjellës gjatë vitit 2017 në nivel sektori arrin shkallën prej 94% e që është për 3% më e lartë se sa në vitin paraprak 2016.


Ky tregues është analizuar duke marrë për bazë të dhënat e dala nga regjistrimi i fundit i vitit 2011 për ekonomitë familjare nga Agjencioni i Statistikave të Kosovës, i korigjuar në bazë të koficienti të rritjes së ekonomive familjare vit pas viti, në raport me numrin e faturave aktuale të raportuara nga KRU.

KRU-të 'Prishtina', 'Gjakova' dhe 'Hidrodrini', kanë arritur mbulueshmëri të lartë të popullatës me shërbime në kuadër të zonave të tyre respektive të shërbimeve.

Fluksi i madh i lëvizjes së banorëve nga zonat rurale në qytetet, e po ashtu edhe në drejtim të kryeqytetit (Prishtinës), ka bërë që KRU 'Prishtina' të ofrojë shërbime edhe për një numër më tepër të popullatës që janë banor rezident në pjesë të tjera të Kosovës, por që njëkohësisht punojnë dhe jetojnë edhe në zonën e kësaj kompanie. Disa nga KRU-të shërbimet e tyre i ofrojnë edhe përtej zonës së tyre të shërbimit, siç është rasti i KRU 'Gjakova', që ofron shërbime edhe për një numër fshatrash në komunën e Prizrenit.

Mbulueshmëria e ultë me shërbimet e ujësjellësit gjatë vitit 2017 vazhdon të jetë në KRU-të 'Hidroregjioni Jugor' me 70%, 'Hidromorava' me 75%, si dhe 'Mitrovica' me 76%.

- b) Mbulueshmëria me shërbime të ujërave të ndotura – nënkupton përqindjen e popullsisë brenda zonës së shërbimit të cilët kanë qasje në shërbimet e ujërave të ndotura të ofruara nga ofruesit e licencuar të shërbimeve.

**Diagrami nr. 2, Norma (%) e Mbulueshmëria së popullatës me shërbimet e ujërave të ndotura**

Siç shifet në diagramin nr. 02, mesatarja e mbulueshmërisë me shërbime të ujërave të ndotura për shtatë ofruesit e shërbimeve në vitin 2017 është 74%.

Edhe ky tregues është analizuar duke marrë për bazë të dhënat e dala nga regjistrimi i fundit i vitit 2011 për ekonomitë familjare nga Agjencioni i Statistikave të Kosovës, i korigjuar në bazë

të koficientit të rritjes së ekonomive familjare vit pas viti, në raport me numrin e faturave aktuale të raportuara nga KRU.


5.6.2. Uji i Pa faturuar (UPF)

Uji i pafaturuar (UPF) paraqet ujin i cili është prodhuar, është shpërndarë por nuk është faturuar (nuk ka arritur të regjistrohet) - ndryshe i quajtur si “humbje e ujit”. UPF nënkupton ujin i cili nuk sjell të ardhura për kompanitë, përderisa prodhimi dhe shpërndarja e tij krijojnë shpenzime.

UPF paraqet humbjet teknike (rrjedhjet), humbjet komerciale (lidhjet ilegale, pasaktësitë gjatë leximit të ujëmatësve, faturimi pa ujëmatës, etj) dhe një sasi e humbjeve të autorizuara (objektet e kultit, zjarrëfikësit, fontanat publike, etj.).

Niveli i lartë i UPF ndikon negativisht në qëndrueshmërinë financiare të ofruesve të shërbimeve të ujit dhe vazhdon të jetë ndër shqetësimet kryesore të sektorit.

Në diagramin e mëposhtëm Nr.03 është paraqitur performanca individuale e ujit të pafaturuar për secilin ofrues të shërbimeve për vitin 2017 (e krahasuar me vitin 2016).



Diagrami nr. 3, Uji i pa-faturuar (UPF)

Niveli i ujit të pa-faturuar në mesatare të sektorit, në raport me ujin e prodhuar dhe distribuar tek konsumatorët, gjatë vitit 2017, shprehur në përqindje, është në nivelin 58%. Në krahasim me vitin 2016, ky tregues ka shënuar zhvillim negativ me rritje 1%.

Për të dhënë një pasqyrë se ku qëndron Kosova në krahasim me vendet e rajonit, në tabelën nr. 08 është paraqitur niveli i ujit të pafaturuar në disa shtetet të rajonit. Të dhënat e kësaj tablele janë marrë nga databaza e IBNET.

Tabela nr. 8-UPF në vendet e rajonit (%)

Shteti	Viti	UPF(%)
Kosova	2016	57%
Shqipëria	2016	67%
Maqedonia	2016	61%
Mali I zi	2015	75%
Bosna e Hercegovina	2016	76%
Serbia	2016	41%
Bullgaria	2016	61%

5.6.3. Efiçenca e faturimit dhe arkëtimit

Tabela në vijim paraqet performancën e shitjeve në nivel të sektorit gjatë 5 viteve.

Tabela nr.9. Vlera monetare në Euro dhe normat për qarkullimin, arkëtimin e keshit

Vitet	Qarkullimi	Arkëtimi/keshi	Keshi/Qarkullimin
2013	29,587,835	21,134,228	71%
2014	29,296,793	21,890,723	75%
2015	31,657,596	23,620,484	75%
2016	33,316,638	28,888,522	87%
2017	34,924,463	29,338,903	84%

Qarkullimi: paraqet të hyrat nga faturimi i rregullt për shërbimet e ujit, subvencionet dhe të hyrat nga aktivitetet e tjera operative në vlerë monetare në nivel të sektorit gjatë vitit 2017. Qarkullimi për periudhën 2013-2017 është përmirësuar për 5,336,628€, apo shprehur në përqindje për 18%.


Efiçenca e arkëtimit (keshi): paraqet arkëtimin nga faturimi i rregullt për shërbimet e ujit, subvencionimin dhe të hyrat nga aktivitetet e tjera operative. Në vitin 2017 ka shënuar përmirësim të lehtë krahasuar me vitin 2016 dhe atë prej 450,381€, apo shprehur në përqindje për 1.6%.

Shkalla e arkëtimit: paraqet raportin e mbledhjes së të ardhurave të faturuara gjatë vitit.

Ngritja e shkallës së arkëtimit prej 13% krahasuar me vitin 2013 ka qenë efekti i ligjit për faljen e borxheve publike, pa lënë pas edhe masat ligjore të ndërmarra nga ofruesit e shërbimeve (ndërprerjet individuale dhe masat tjera ligjore e operative).

Shkalla e arkëtimit është njëri prej treguesve më domethënës i cili krahas efiçencës së faturimit dhe reduktimit të humbjeve të ujit ka impakte të drejtpërdrejta në qëndrueshmërinë financiare

të ofruesve të shërbimeve. Në diagramin në vijim është paraqitur performanca individuale e ofruesve të shërbimit sa i përket shkallës së arkëtimit duke krahasuar vitin 2017 me vitin 2016.



Diagrami nr. 4. Shkalla e arkëtimit

Shkalla e arkëtimit në nivel të sektorit për vitin 2017 është 83%. Në krahasim me vitin 2016, në nivel të sektorit, ky tregues ka shënuar rënie për 3%. Kjo rënie është si pasojë e ngritjes së nivelit të faturimit duke mos arritur që në të njëjtin nivel të jetë edhe arkëtimi.

5.6.4. Proporcioni i konsumatorëve me ujëmatës

Ky tregues paraqet proporcionin e konsumatorëve të pajisur me ujëmatës funksional, të ndarë me numrin e përgjithshëm të konsumatorëve të ofruesit të shërbimeve për vitin 2017.



Diagram nr. 05. Proporcioni (%) e konsumatorëve shtëpiak me ujëmatës

Në nivel të sektorit mbulimi me ujëmatës për kategorinë e konsumatorëve shtëpiak është rritur për 1%, dhe në vitin 2017 ka arritur nivelin në 93%.

Për të dhënë një pasqyrë se ku qëndron Kosova në krahasim me vendet e rajonit, në tabelën nr. 10 është paraqitur proporcioni i konsumatorëve me ujëmatës në disa shtete të rajonit. Të dhënat e kësaj tablele janë marrë nga databaza e IBNET.

Tabela nr. 10, Proporcioni i konsumatorëve me ujëmatës (%) në vendet e rajonit

Proporcioni i Konsumatorëve më ujëmatës (%)		
Vendet e rajonit	2015	2016
Shqipëria	64.86%	64.6%
Maqedonia	91.75%	93.62%
Mali i Zi	77.71%	-
Bosnja e Hercegovina	99.94%	100%
Serbia	95.25%	95%
Bulgaria	98.60%	97.95%
Kosova	92%	93%

5.6.5. Investimet kapitale për ujësjellës dhe ujëra të ndotura

Në tabelën vijuese nr. 11, janë dhënë vlerat e realizuara të investimeve për gjatë viteve (2013-2017), si nga mjetet vetanake të KRU, po ashtu edhe nga donatorët.

Tabela nr. 11. Vlera në Euro e investimeve të realizuara

Viti	Vlera(€)
2013	14.9mil.€
2014	9.5mil.€
2015	5.9mil.€
2016	12.8mil.€
2017	18.59 mil.€

Në përgjithësi nga të gjitha KRU, gjatë vitit 2017 janë realizuar vetëm 49% e investimeve kapitale nga shuma e planifikuar (37.93 mil.€).

5.6.6 Performanca e NHE-Iber Lepenci

ARRU është përgjegjëse për rregullimin e pjesës së afarizmit të NHE 'Iber Lepenci' vetëm për pjesën e cila ka të bëjë me furnizimin e ujit me shumicë për KRU 'Mitrovica' dhe KRU 'Prishtina' gjegjësisht për Nj. O 'Drenas'.

Në tabelën në vijim janë disa të dhëna statistikore dhe disa tregues të performancës për të parë trendët e zhvillimit të performancës në vitin 2017 në raport me vitin 2016.

Tabela 12. Të dhënat statistikore për NHE 'Ibër-Lepenc'

Të dhënat statistikore për 2016 / 2017	2016	2017
Vëllimi ujit me shumicë të faturuar (m ³)	24,240,235	38,040,970
Faturimi për ujiin me shumicë (€)	539,543	1,265,859
Arkëtimi për ujiin me shumicë (€)	239,014	765,570
Kostoja e operimit për furnizimin e ujit me shumicë (€)	665,709	959,879
Numri i punëtorëve të angazhuar në furnizimin e ujit me shumicë	39	39

Meqenëse natyra e shërbimeve të ujit me shumicë është më ndryshe nga aktivitetet e furnizimit me ujë të pijshëm, mundësia e vlerësimit të performancës është e kufizuar vetëm në disa tregues financiar.

Në tabelën nr. 13, është dhënë një pasqyrë e treguesve financiar në bazë të cilëve mund të vlerësohet performanca e NHE 'Ibër-Lepenci' gjatë vitit 2017 krahasuar me vitin 2016.

Tabela 13. Treguesit e Performancës së NHE 'Ibër-Lepenci'

Treguesi i performancës	2016	2017
Shkalla e arkëtimit	44%	60%
Norma e punës	0.81	1.32
Norma e mbulimit të punës	0.36	0.80
Kostoja e operimit për njësi (€/m ³)	0.03	0.03

Siç po vërehet edhe nga tabela gati të gjithë treguesit financiar të kësaj kompanie kanë shënuar progres në vitin 2017 në raport me vitin 2016.

5.7. Inspektimi dhe zbatimi i standardeve të shërbimit

Edhe gjatë vitit 2017 vëmendje dhe fokus të veçantë i është kushtuar zbatimit të standardeve të shërbimit.

Përmes aktiviteteve të inspektimit është përcjellë zbatimi i rregullores për standardet minimale të shërbimeve, zbatimi i rekomandimeve për përmirësim të dala nga inspektimet e vitit 2016, si dhe zbatimi i akteve tjera të nxjerra nga ARRU.

Në vazhdim të këtij kapitulli janë të paraqitur më detalisht disa prej standardeve të shërbimit të cilat përmes inspektimeve janë përcjellë gjatë vitit 2017, veprimet e ndërmarra nga ARRU dhe rezultatet e arritura nga këto aktivitete.

5.7.1. Verifikimi i mënyrës së matjes së ujit të prodhuar në të gjitha pikat e prodhimit.

Me qëllim të verifikimit të matjes së ujit të prodhuar, ashtu siq është specifikuar në rregulloren për standardet minimale të shërbimeve, është përmbyllur inspektimi i zhvilluar për shtatë (7) ofruesit e licencuar të shërbimeve. Inspektimi ka filluar në vitin 2016 dhe është përmbyllur duke përfshirë edhe inspektimin verifikues të përmbushjes së rekomandimeve të ARRU në vitin 2017.

Gjatë këtij aktiviteti janë inspektuar të gjitha pikat e prodhimit (gjithsejt 98) për të cilat ofruesit e shërbimeve kanë deklaruar se bëhet matja e ujit të prodhuar.

Bazuar në të gjeturat nga inspektimi është vërejtur se matja e ujit të përpunuar në nivel vendi (për shtatë ofruesit e shërbimeve) ka qenë 65%.

ARRU i ka obliguar ofruesit e shërbimeve që në një afat kohor të vendosin matës të prodhimit të ujit në pikat ku matësit kanë munguar.

Si rezultat i masave të ndërmarra nga ARRU, me rastin e zhvillimit të inspektimit verifikues për përmbushjen e rekomandimeve të ARRU, matja e ujit të përpunuar në nivel vendi (për të gjithë ofruesit e shërbimeve) nga 65% ka arritur në 94%. *(s qarim: 4% të mbetura nënkuptojnë gabimet teknike në raportime të cilat janë gjetur gjatë inspektimit).*

5.7.2. Inspektimi i zbatimit të akteve ligjore, nënligjore, urdhëresave dhe vendimeve të ARRU.

Ky aktivitet ka përfshi inspektimin në terren, përgaditjen e raporteve të inspektimit, rekomandimet dhe inspektimet verifikuese për zbatimin e rekomandimeve për çështjet në vijim:

a) Zbatimi i taksës administrative të kyçjes - Nga muaji qershor 2016 përmes urdhëresës tarifore të shërbimeve, ARRU ka zbritur taksën administrative për kyçje në shërbime të ujit nga 50€ në 5€.

Me qëllim të verifikimit të zbatimit të kësaj urdhërese ARRU gjatë vitit 2016 ka zhvilluar inspektime tek të shtatë ofruesit e licencuar të shërbimeve. Gjatë këtyre inspektimeve është gjetur se tre nga ofruesit e shërbimeve (KRU “Prishtina”, KRU “Bifurkacioni dhe KRU “Mitrovica”) kanë vazhduar me ngarkesën prej 50€ për një periudhë kohore edhe pas hyrjes në fuqi të urdhëresës së re tarifore. ARRU i ka obliguar ofruesit e shërbimeve që në një afat kohor të bëjnë për përmirësimin e këtyre shkeljeve.

Me qëllim të verifikimit të përmbushjes së rekomandimeve të dhëna, gjatë vitit 2017 janë zhvilluar inspektimet verifikuese për KRU “Prishtina”, KRU “Bifurkacioni dhe KRU “Mitrovica”. Gjatë inspektimeve verifikuese është vërtetuar se këta tre ofrues të shërbimeve i kanë zbatuar rekomandimet e ARRU dhe si rezultat janë kompensuar (në formë parapagimi apo largim nga borxhi i përgjithshëm) gjithsej 721 konsumatorë me nga 45€.

b) Zbatimin e mënjanimit të taksës për kyçjet ilegale – Nga muaji qershor 2016 përmes urdhëresës tarifore të shërbimeve, ARRU komform ligjit në fuqi ka hequr taksën (gjobën) për kyçjet ilegale prej 100€.

Me qëllim të verifikimit të zbatimit të kësaj urdhërese, gjatë vitit 2016 ARRU ka zhvilluar inspektime tek të shtatë ofruesit e licencuar të shërbimeve. Gjatë këtyre inspektimeve është gjetur se KRU “Prishtina” ka vazhduar me zbatimin e kësaj gjobe për një periudhë kohore edhe pas hyrjes në fuqi të urdhëresës tarifore. ARRU e ka obliguar ofruesin e shërbimeve që në një afat kohor të bëjnë përmirësimin e këtyre shkeljeve.

Me qëllim të verifikimit të përmbushjes së rekomandimeve të dhëna, gjatë vitit 2017 është zhvilluar inspektimi verifikues për KRU “Prishtina”, me ç’rast është vërtetuar se janë zbatuar rekomandimet e ARRU dhe si rezultat ky ofrues i shërbimeve ka kompensuar (në formë parapagimi apo largim nga borxhi i përgjithshëm) gjithsej 133 konsumatore me nga 100€.

5.7.3. Verifikimi i zbatimit të procedurave për pranimin, shqyrtimin dhe përgjigjen ndaj ankesave të konsumatorëve

Në bazë të nenit 48 të ligjit Nr.05/L-42, gjatë vitit 2017 ARRU ka aprovuar “Procedurat për pranimin, shqyrtimin dhe përgjigjen ndaj ankesave të konsumatorëve”.

Me qëllim të verifikimit të zbatimit të këtyre procedurave është zhvilluar inspektim tek të gjithë ofruesit e shërbimeve. Gjatë inspektimit është gjetur se një nga ofruesit e shërbimeve (KRU “Hidrodrini”) nuk i plotëson këto procedura.

ARRU e ka obliguar ofruesin e shërbimeve që brenda një afati të dhënë kohor të plotësojë procedurat e aprovuara nga ARRU.

Me qëllim të verifikimit të zbatimit të rekomandimeve, është zhvilluar inspektimi verifikues në KRU “Hidrodrini” dhe është vërtetuar se ky ofrues i shërbimeve i ka zbatuar rekomandimet e dhëna nga ARRU.

5.7.4. Verifikimin e Zbatimit të Vendimeve të Komisioneve Këshilluese të Konsumatorëve (KKK) nga ana e ofruesve të shërbimeve

Në bazë të nenit 26 të ligjit Nr.05/L-42, ARRU ka themeluar Komisionet Këshilluese të Konsumatorëve (KKK) për secilën zonë të shërbimeve. Ndër përgjegjësitë e këtyre komisioneve është edhe marrja e vendimeve lidhur me ankesat e konsumatorëve të cilët janë të pakënaqur me përgjigjet e marra nga ofruesit e shërbimeve. Ofruesit e shërbimeve janë të obliguar të zbatojnë vendimet e KKK apo të bëjnë ankesë në gjykatën kompetente.

Me qëllim të verifikimit të këtyre procedurave është zhvilluar inspektim tek të gjithë ofruesit e shërbimeve. Gjatë inspektimit janë gjetur vetëm dy raste (një rast në KRU “Mitrovica” dhe një rast në KRU “Hidromorava”) për të cilat KRU nuk ka ndërmarrë hapat e përshkruar më lart.

Pas pranimit të rekomandimeve përmes raporteve të inspektimit, rastet janë zgjidhur në favor të konsumatorëve.

5.7.5. Inspektimi për verifikimin e zbatimit të nenit 37 të Rregullores për standardet minimale të shërbimeve të ujit në Kosovë - (Rr. Nr. 02/2016) - “Faturimi i konsumatorëve në rastet me ujëmatës të përbashkët (ndërtesat e banimit kolektiv)”

Bazuar në nenin 37 të Rregullores për standardet minimale të shërbimeve të ujit në Kosovë - (Rr. Nr. 02/2016) ofruesit e shërbimeve janë të obliguar që faturimi i konsumatorëve në rastet me ujëmatës të përbashkët (nëndërtesat e banimit kolektiv) të bëhet sipas:

- a. Leximit të ujëmatësit individual (kur konsumatori ka ujëmatës individual)

- b. Sipas numrit të anëtarëve të bashkësisë familjare (dëshmuar përmes listave valide të nënshkuara nga të gjithë konsumatorët)
- c. Numrit të banorëve të planifikuar për sipërfaqe të banimit (sipas standardeve të dimensionimit të hapësirës së banimit).

Me qëllim të verifikimit të zbatimit të këtij standardi ARRU ka zhvilluar inspektime tek të shtatë ofruesit e licencuar të shërbimeve.

Gjatë këtyre inspektimeve është gjetur se një nga ofruesit e shërbimeve (KRU "Prishtina") nuk e zbaton këtë standard të shërbimit dhe vazhdon të shpërndajë ngarkesën e lexuar në ujëmatësin e përbashkët njëtrajtësisht për të gjithë konsumatorët të cilët i përkasin kësaj kategorie.

Me këtë rast ARRU me datë 05.12.2017 në pajtim me nenin 39.3.1 të Ligjit Nr.05/L-042 dhe nenit 43.2 të Rregullores Nr. 02/2016 ka proceduar Paralajmërimin për KRU "Prishtina" (nr.protok.639/2 të dt.05.12.2017). Me kalimin e afatit të dhënë në paralajmërim (60 ditë pune), do të zhvillohet inspektimi verifikues dhe nëse KRU nuk e zbaton plotësisht nenin 37, ARRU do të ndërmerri masat e parapara me ligj.

5.7.6. Verifikimi i zbatimi i nenit 36 të Rregullores për standardet minimale të shërbimeve të ujit në Kosovë - (Rr. Nr. 02/2016) - "Faturimi i konsumatorëve pa ujëmatës":

Duke pasur parasysh se kategoria më e ndjeshme për përmbushjen e këtij standardi janë konsumatorët shtëpiak pa ujëmatës - apartamente, inspektimi është bërë pikërisht për këtë kategori. Meqenëse ofruesi i shërbimeve nuk ka mundësi teknike të shkyçjeve individuale, ndërsa shkyçjet kolektive janë të ndaluara, gjatë inspektimit është verifikuar mënyra e llogaritjes së faturimit të konsumatorëve pa ujëmatës dhe zbatimi i vendimeve të ARRU për këtë kategori të konsumatorëve. Gjatë inspektimit është vërtetuar se dy nga ofruesit e shërbimeve (KRU "Gjakova" dhe KRU "Hidrodrini") nuk i zbatojnë ngarkesat e aprovuara nga ARRU.

Duke zbatuar procedurat e inspektimit, janë përgatitur raportet e inspektimit me rekomandime për përmirësimin e këtyre shkeljeve (kompensimin e konsumatorëve të dëmtuar dhe respektimi i ngarkesave paushalle të aprovuara nga ARRU). Me kalimin e afatit për përmirësim (shkurt 2018), ARRU do të bëjë inspektimin verifikues dhe do të ndërmarrë hapat e mëtejshme në bazë të të gjeturave nga inspektimet verifikuese.

5.8. Roli dhe aktivitetet e Komisioneve Këshilluese të Konsumatorëve (KKK)

Në funksion të mbrojtjes së interesave të konsumatorëve, konform nenit 26 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-042, si dhe konform Nenit 5 të Rregullores për Komisionin Këshillues të Konsumatorëve për shërbimet e ujit në Kosovë (Nr.01/2016), janë themeluar dhe funksionojnë Komisionet Këshilluese të Konsumatorëve (KKK).

KKK numërojnë gjithsej 32 anëtarë, janë të themeluara në shtatë (7) Rajone të Kosovës dhe me nga një anëtar janë të përfaqësuara të gjitha komunat e Republikës së Kosovës, përveç veriut të Kosovës.

Anëtarët e këtyre komisioneve janë zgjedhur në bazë të intervistimit të kandidatëve të propozuar nga Kryetarët e Komunave.

Komisionet Këshilluese të Konsumatorëve mbajnë takime në baza mujore, në të cilat përveç të tjerave shqyrtohen ankesat e konsumatorëve të cilët kanë parashtruar ankesë pranë KKK përkatëse.

Orari i takimeve të KKK publikohet në media dhe në ueb faqe të ARRU dhe këto takime janë të hapura për publikun.

Gjatë vitit 2017 janë mbajtur 92 takime të KKK, të cilat çdo herë kanë qenë të monitoruara dhe të ndihmuara nga përfaqësuesit e ARRU. Në këto takime përveç shqyrtimit të ankesave të konsumatorëve janë shqyrtuar edhe shumë çështje me rëndësi të cilat drejtpërdrejtë ndikojnë në interesin e konsumatorëve siç janë :

- Shqyrtimi i ankesave të konsumatorëve;
- Shqyrtimi i informacionit dhe analizimi i procedurave lidhur me shqyrtimin e ankesave të konsumatorëve;
- Informacion lidhur me lidhjen e Kontratave të Shërbimit;
- Informacion lidhur me leximin e ujëmatësve;
- Shqyrtimi i raportit të performancës së ofruesëve të shërbimeve;
- Shqyrtimi i situatës lidhur me furnizimin me ujë të konsumatorëve;
- Shqyrtimi i tarifave për ujë dhe kanalizim për vitet në vijim;
- Shqyrtimi rreth hartimit të akteve nënligjore të ARRU-së;
- Shqyrtimi i çështjeve tjera të cilat janë në interes të konsumatorëve;


Në shumë raste gjatë vitit 2017 në këto takime kanë marrë pjesë edhe konsumatorët, përfaqësuesi i departamentit për mbrojtje të konsumatorëve (MTI) , OJQ-të dhe mediat.

Në vijim është dhënë në formë tabelore dhe diagrami, numri i ankesave të parashtruara dhe të shqyrtuara nga Komisioni Këshilluese i Konsumatorëve për të gjitha rajonet e Kosovës.

Tabela Nr.14, numri i ankesave të parashtruara dhe të shqyrtuara nga KKK-të rajonale

RAJONI	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qersho	Korrik	Gusht	Shtato	Tetor	Nëntor	Dhjeta	Gjithse
Prishtinë	14	16	10	25	18	13	10	9	7	14	16	15	167
Mitrovicë	2	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	2
Pejë	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Gjakovë	2	-	-	1	-	1	1	6	-	1	-	-	12
Prizren	-	-	-	1	1	-	-	4	4	-	2	1	13
Ferizaj	6	4	3	10	-	5	1	13	3	3	3	6	57
Gjilan	3	2	-	3	-	1	-	3	1	-	2	-	15
Gjithsej	27	22	13	40	19	20	12	35	15	18	23	22	266

Numri i ankesave të parashtruara nga konsumatorët shprehur në përqindje (%)



Rezultati i shqyrtimit të ankesave të parashtruara është :

Nga 266 ankesa të parashtruara në KKK, 228 janë zgjidhur, 16 janë dërguar njoftim për palët, 8 janë të palejuara (çështje të cilat nuk janë në kompetencë të KKK për tu zgjidhur), 12 nuk janë shqyrtuar për shkak të kalimit të afatit për ankesë dhe 2 lëndë janë në gjykatë.

Bazuar në analizimin më të hollësishëm të ankesave në vijim është paraqitur një përmbledhje e kategorizuar e ankesave:

a) Shpërndarja e ankesave sipas KKK regjionale:

Siç shihet edhe nga tabela Nr. 14, numri më i madh i ankesave është evidentuar në KKK Prishtinë me 167 ankesa.

b) Natyra e ankesave:

- Kontestim i borxhit – 188 ankesa
- Zbritja apo shlyerja e borxhit – 9 ankesa
- Faturim paushall – 43 ankesa
- Faturim i lartë/mbifaturim – 10 ankesa
- Të tjera – 16 ankesa

c) Kategoritë e konsumatorëve:

- Nga të gjitha ankesat e pranuar, 234 ankesa janë nga konsumatorët shtëpiak;
- Nga të gjitha ankesat e pranuar, 32 ankesa janë nga konsumatorët joshtëpiak;

5.9. Aktivitetet në konsolidimin institucional

Në këtë kapitull janë paraqitur aktivitetet në fushën e legjislativit, të cilat ARRU i ka ndërmarrë gjatë vitit 2016 në pajtim me Planin Strategjik 2015-2017 dhe në bazë të obligimeve dhe kompetencave të cilat i ka.

5.9.1. Aktivitetet në planin legjislativ

Gjatë vitit 2016 përveç harmonizimit të akteve nënligjore me Ligjin Nr.05/L-042 (të cilat janë shpjeguar në kapitujt e mësipërm), ARRU ka hartuar edhe dokumente tjera siç janë:

5.9.1.1. Hartimi i planeve, raporteve, udhëzuesve dhe dokumenteve tjera

- **Përpilimi i Planit Strategjik 2018 – 2020 të ARRU** – me qëllim të përcaktimit të drejtimit dhe synimeve të ARRU në përmbushjen e misionit dhe vizionit për tri vitet e ardhshme, është përpiluar Plani Strategjik 2018 - 2020. Ky plan përveç që do të shërbejë ARRU për udhëheqjen në vendimet e përditshme do të shërbejë edhe për vlerësimin e progresit të institucionit tonë.
- **Përpilimi i Planit të Punës 2018** – bazuar në planin Strategjik 2018 - 2020, në planet e punës së njërive përkatëse të ARRU dhe me qëllim të definimit të aktiviteteve për vitin 2018, është përpiluar Plani i Punës për vitin 2018. Ky plan paraqet aktivitetet e njëpasnjëshme të institucionit përgjatë periudhës njëvjecare, të cilat të ndërlihdura me njëra tjetrën kontibuojnë në arritjen e qëllimeve dhe synimeve të ARRU.
- **Përpilimi i Raportit të punës për vitin 2016** – Si çdo vit, edhe gjatë vitit 2017, Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit (ARRU) ka përgatitur dhe dorëzuar në Kuvendin e Republikës së Kosovës Raportin vjetor të punës për vitin paraprak (2016). Ky raport paraqet aktivitetet dhe arritjet e ARRU në përmbushjen e mandatit ligjor për vitin raportues, sipas Ligjit për rregullimin e shërbimeve të ujit (Ligji Nr.05/L-42) si dhe një pasqyrë të përgjithshme të gjendjes së sektorit të shërbimeve të ujit në Kosovë.
- **Udhëzuesi për matjen e prodhimit të ujit** – bazuar në rregulloren për standardet minimale të shërbimeve (Nr.02/2016), me qëllim të monitorimit të matjes së sasisë së

ujit të përpunuar, ofruesit e shërbimeve janë të obliguar të instalojnë paisje të përshtatshme për matjen e ujit të përpunuar. Me qëllim të standardizimit të instalimit të këtyre matësve dhe lehtësimit të punës së ofruesve të shërbimeve, ARRU në bashkëpunim edhe me palët tjera (KNMU) ka përpiluar Udhëzuesin për matjen e prodhimit të ujit.

- **Udhëzimi Administrativ për taksën e Licencimit** - Në pajtim me autoritetin e dhënë me nenin 14 të Ligjit Nr.05/L-042, për rregullimin e shërbimeve të Ujit, pas konsultave me MF lidhur me dëgjimet buxhetore dhe miratimin e buxhetit për vitin 2017 nga Kuvendi i Kosovës, Drejtori i ARRU nxjerr Udhëzim Administrativ i cili hyn në fuqi më 01 janar 2017. Lartësia e TVL për ofruesit e shërbimeve për vitin 2017 në total është 360,037.34 EURO.
- **Azhurnimi i ueb faqes** – ARRU përmes Agjensisë Qendrore të Prokurimit, ka nënshkruar kontratë me datën: 16.10.2017, me numer të protokollimit të AQP-se: A.Q.P me N.Sh. Spin Agency, me titull “Dizajnimi dhe zhvillimi i ueb faqes së re të Autoriteti Rregullator për Shërbime të Ujit”. E gjithë puna me kërkesat e ARRU për ndryshime është realizuar dhe është pranuar me datë 19.12.2017.
- **E-pasuria** – Programi E-pasuria ka hyrë në funksion në dhjetor të vitit 2017. Ka ndërprerje të funksionimit sepse këtë program e menaxhon MAP.
- **Databaza e personelit** - Ka filluar të menaxhohet përmes sistemit E të Burimeve Njerëzore dhe ka hy në funksion në qershor të vitit 2017.

5.9.1.2. Paralajmërimet

Me qëllim të përmbushjes së obligimeve, gjatë vitit raportues, ARRU ka proceduar tri (3) Paralajmërimet për;

- i. KRU”Prishtina”-inspektimi i zbatimit të akteve normative të ARRU- taksa e kyçjes;
- ii. KRU”Prishtina”-inspektimi për zbatimin e nenit 37 të R02/2016-faturimi në ndërtesat kolektive;
- iii. KRU”Mitrovica”- mos pagesa e TVL;

5.9.1.3. Procedurat Gjyqësore

Gjatë vitin 2017, ARRU është paditur në Gjykatën Themelore të Prishtinës nga ana e konsumatorëve, të cilët kanë kundërshtuar vendimet e Komisionit Këshillues të Konsumatorëve, lidhur me ankesat e tyre. Konsumatorët e pakënaqur me vendimet e KKK-ve nga të gjitha rajonet e Kosovës kanë paditur ARRU-në ku numri i padive ishte gjithsej 20. Nga 20 paditë nga Gjykata Themelore të Prishtinës i ka shqyrtuar 6 raste (shqyrtime kryesore). Në të gjitha rastet e shqyrtuara, Gjykata Themelore ka nxjerrë aktgjykim refuzues për paditësin, d.m.th aktgjykimet janë në favor të ARRU.

5.10. BASHKËPUNIMI ME INSTITUCIONET TJERA

Bashkëpunimi i hapur i ARRU me të gjitha palët e interesit (vendore dhe ndërkombëtare) përmes koordinimit të aktiviteteve, shkëmbimit të informatave, përvojave etj, me qëllim të arritjes së rezultateve pozitive në sektorin e ujit ka qenë aktivitet i vazhdueshëm edhe gjatë vitit 2016. Në vijim në pika të shkurta janë paraqitur institucionet me të cilat ARRU ka bashkëpunuar gjatë vitit raportues dhe përmbledhjen e shkurtër të qëllimit dhe aktiviteteve të ARRU me këto institucione:

- a) **Bashkëpunimi me Komisionin për Bujqësi, Pyltari, Zhvillim Rural, Mjedis e Planifikim Hapësinor** - Gjatë gjithë vitit raportues, ARRU i është përgjigjur të gjitha kërkesave të këtij komisioni. Kryetari i këtij komisioni ka aprovuar kërkesën e ARRU për Amandamentimin e Ligjit Nr. 05/L-042.
- b) **Bashkëpunimi me Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKSHPK)**
Në bazë të Memorandumit të Bashkëpunimit që kemi nënshkruar me IKSHPK në vitin 2007, edhe gjatë këtij viti ARRU ka vazhduar bashkëpunimin përmes një numri aktiviteteve në fushën e monitorimit të kualitetit të ujit si dhe jemi angazhuar në ofrimin e ndihmës për KRU, në përmbushjen e përgjegjësisë të cilat dalin nga UA 16/2012 për kualitetin e ujit. Kemi dhënë kontributin tonë në lidhje me përpilimin e Rregulloreve dhe procedurave të cilat dalin nga UA 16/2012- për kualitetin e ujit.
- c) **Bashkëpunimi me Njësinë për Politika dhe Monitorim të Ndërmarjeve Publike (NJPMNP) të MZHE** -ARRU ka vazhduar bashkëpunimin me këtë subjekt në të cilat janë diskutuar problemet e shfaqura në operimin e kompanive rajonale të ujësjellësit. Gjatë vitit 2017 kemi zhvilluar takime të përbashkëta me qëllim të zhvillimit të sektorit.
- d) **Bashkëpunimi me Ministrinë për Integritet Evropian (MIE)**
Arru ka pregaditur dhe raportuar sipas kërkesave të MIE për “Inputet e Raportit të KE-së për Kosovën”, për takimin e “Nën - Komitetit për MSA-së për Mjedis, Transport, Energji dhe Zhvillim Rajonal” dhe për Komisionin Ekzekutiv “Infrastruktura”. Gjatë vitit përfaqësuesit e ARRU kanë marrë pjesë në takime dhe punëtori të organizuara nga MIE lidhur me eksperiencat e shteteve tjera për procedurat e pregaditjes së raporteve dhe mënyrës së raportimit.
- e) **Bashkëpunimi me MTI** - ka vazhduar bashkëpunimi me MTI, posaqërisht me Departamentin për Mbrojtje të Konsumatorëve. Në këtë drejtim kemi marrë pjesë në punëtoritë e organizuara nga ky departament përmes diskutimeve dhe prezantimeve, si dhe në disa raste përfaqësuesit e Departamentit për Mbrojtje të Konsumatorëve kanë marrë pjesë në takimet e Komisioneve Këshilluese të Konsumatorëve (KKK).
- f) **Bashkëpunimi me pushtetin lokal** – me qëllim të gjetjes së zgjidhjeve më të favorshme për furnizim me ujë të konsumatorëve, ARRU ka mbajtur takime me Kryetarët e Komunave të Hanit të Elezit, Ferizajit dhe Shtërpces.
- g) **Bashkëpunimi me Zyrën e Këshillit Ndër- Ministror të Ujit (KNMU)**, e cila funksionon në kuadër të Kryeministrit. Gjatë tërë vitit kemi pasur shumë takime, që kanë të bëjnë me punën e gjithëmbarshme të ofruesve të licencuar të shërbimeve dhe donatorëve

ndërkomtar. Bashkëpunim më i theksuar gjatë vitit 2017 me përfaqësuesit e kësaj zyre ka qenë lidhur me unifikimin e akteve interne të punës së ofruesve të shërbimeve, udhëzuesit për matjen e ujit.

- h) Bashkëpunimi me Avokatin e Popullit** – duke i u përgjigjur rekomandimeve të Raportit të Avokatit të Popullit lidhur me faturimin paushall dhe faturimin e konsumatorëve në bazë të ujëmatësit të përbashkët, është përpiluar raporti me sqarime rreth aktiviteteve të ndërmarra nga ARRU lidhur me çështjet e ngritura si dhe janë mbajtur takime me qëllim të sqarimit dhe gjetjes së një zgjidhje më të mirë të mundshme.
- i) Bashkëpunimi me Agjencionin e Statistikave të Kosovës (ASK).** Duke i u përgjigjur kërkesave të këtij Agjencioni, ARRU i ka përgaditur dhe përcjellë të dhënat lidhur me shërbimet e ujit.
- j) Bashkëpunimi me SHUKOS** (Shoqata e Ujësjiellësve të Kosovës) – gjatë vitit 2017, përveç bashkëpunimit të rregullt të cilin e kemi me këtë Shoqatë, stafi përgjegjës i ARRU ka marrë pjesë në punëtoritë e organizuara të kësaj Shoqate duke dhënë kontribut në përpilimin e akteve të brendshme ligjore të ofruesëve të shërbimeve. Lidhur me këtë çështje janë mbajtur disa takime. ARRU ka marrë pjesë edhe në punëtoritë dhe seminarët të cilat kjo shoqatë I ka organizuar në bashkëpunim me SHUKALB (Shoqata e ujësjiellës kanalizimeve të Shqipërisë). Në punëtorinë e organizuar nga SHUKOS/SHUKALB, ARRU ka ndarë eksperiencat e veta përmes prezantimit me temën “Analiza e Performancës së KRU”. Me ftesë të SHUKOS janë mbajtur edhe dy takime tjera ku janë diskutuar disa çështje siç janë: Përcaktimi i tarifave dhe ngarkesat tarifore, Udhëzimi Administrativ për TVL, harmonizimi i Biznis Planeve, rastet sociale, çështja e treguesve/harmonizimi i tyre etj.
- k) Bashkëpunimi me Entin Rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura (ERRU), Shqipëri** - bashkëpunim I rregullt i formalizuar me një Marrëveshje Bashkëpunimi në vitin 2009. Janë mbajtur takime dhe vizita të ndërsjellta me qëllim të shkëmbimit të përvojave.
- l) Bashkëpunimi me Komisionin Rregullator Shtetëror për Energji dhe Ujë të Bullgarisë (SEWRC)** – në bazë të Marrëveshjes për Bashkëpunim formalizuar me 17.09.2014, me 07 qershor 2017 u mbajt takimi i përbashkët me përfaqësuesit e Rregullatorit për Energji dhe Ujë të Bullgarisë (SEWRC), në Prishtinë. Në takim u diskutuan dy çështje kryesore: korniza ligjore në të dy Rregullatorët, si dhe reformat në sektorin e ujit në të dyja vendet. Diskutimet ishin mjaft intensive, dhe të dyja palët me pozitivitet u dakorduan dhe treguan gatishmërinë për vazhdimin e bashkëpunimit dhe ndarjen e përvojave të ndërsjellta.
- m) Bashkëpunimi me përfaqësuesit e donatorëve** (SDC, SCO, GTZ, KFW, USAID etj.) dhe konsulentëve që kanë qenë aktiv në sektorin e ujërave në Kosovë. Janë mbajtur takime, shkëmbim i përvojave, informatave dhe pjesëmarrje në punëtori të ndryshme me interes për sektorin.
Në kuadër të këtyre bashkëpunime, vlen të theksohet bashkëpunimi me DORSCH/CDI (projekti implementues i fazës V –të për rehabilitimin e sistemeve rurale të ujësjiellësit, i

financuar nga Qeveria Zvicerane dhe Qeveria e Kosovës). Edhe gjatë vitit 2017 ARRU ka pasur mbështetje institucionale (konsulencë) në kuadër të fazës V-të të këtij projekti.

- i) Bashkëpunimi me IAWD /DANUBIS** - në kuadër të benchmarkingut regional dhe ndërkombëtarë kemi raportuar në platformën e Kosovës në kuadër të DANUBIS, si dhe kemi raportuar në rrjetin ndërkombëtarë të benchmarkingut (IBNET) për vitin 2016.
- j) Nënshkrimi i Memorandumit të Mirëkuptimit (Latvia)**- me 01 nëntor 2017, ARRU nënshkruan Marrëveshje Bahskëpunimi me Komisionin për Ofruesit e Shërbimeve Publike të Latvisë. Qëllimi i kësaj marrëveshjeje është promovimi i interesave të përbashkëta për aspektet e rregullimit të menaxhimit të furnizimit me ujë dhe sistemit të kanalizimit, me ç'rast do të jetë bazë e një kornize për zhvillimin e bashkëpunimit afatgjatë dhe shkëmbimit të informacionit në bazë të barazisë, reciprocitetit dhe përfitimeve të përbashkëta.
- k) Anëtarësimi në WAREG (Shoqata e Rregullatorëve Evropian të Ujit)** - Pas shqyrtimit të kërkesës së ARRU për anëtarësim në WAREG, me 20 qershor 2017 ARRU është pranuar zyrtarisht si anëtare me të drejta të plota të kësaj shoqate. Bashkëpunimi me këtë shoqatë ka vazhduar gjatë gjithë vitit përmes pjesëmarrjes në takime, shkëmbimit të informatave etj. Aktualisht kjo Shoqatë i ka 30 shtete anëtarë dhe 5 të tjera vëzhgues nga shtetet e Evropës me qëllim kryesor për:
- Shkëmbimin e informatave dhe praktikave
 - Rritjen e bashkëpunimit teknik dhe institucional mes anëtarëve të WAREG-ut
 - Promovimin e ngritjes së kapaciteteve, rregullimin e qëndrueshëm dhe mbrojtjen e konsumatorit
 - Zhvillimi i dialogut me institucionet e BE-së si dhe me palët e interesit në nivel evropian dhe ndërkombëtar.

Me të gjitha palët (Kosovare dhe ato jashtë vendit) përmes takimeve të drejtpërdrejta, punëtorive dhe prezantimeve, ARRU ka dhënë kontribut duke paraqitur qëndrimin e vet lidhur me arritjet dhe ngeçjet e sektorit. Bashkëpunimi me të gjitha palët gjithashtu na ka ndihmuar të informohemi me zhvillimin e sektorit dhe përvojat e vendeve tjera.

5.11. RELACIONET ME PUBLIKUN

5.11.1. Bashkëpunimi me media

Gjatë vitit 2017 përmes organizimeve (dëgjimeve publike) dhe deklaratave për shtyp, opinioni publik është informuar për aktivitetet e Autoritetit Rregullator për Shërbimet e Ujit në përgjithësi.

- **Kampanja për informimin e të drejtave të konsumatorëve**, është lançuar në televizionin publik RTK gjatë muajit dhjetor 2016 dhe ka vazhduar edhe gjatë muajit janar 2017. Ky njoftim është përgatitur me qëllim të informimit të konsumatorëve për Kartën e Konsumatorëve, rolin dhe detyrat e Komisioneve Këshilluese të Konsumatorëve, si dhe adresën e duhur të parashtrimit të ankesave nga konsumatorët në rastin e pakënaqësive ndaj KRU-ve.

- **Komunikatat për shtyp rreth tarifave,** njoftimi i publikut se ARRU për vitin 2017 nuk ka bërë ngritje të tarifave volumetrike për asnjërin nga Ofruesit e Shërbimeve (KRU-të);
- **Komunikatat për shtyp** njoftimi i publikut se ARRU ka filluar procesin e rregullt për tarifën e shërbimeve të ujit të shtatë KRU-ve, për periudhën e ardhshme tre vjeçare 2018-2020
- **Degjimet publike për tarifa:** ARRU njoftoi të gjitha palët e interesuara se duke filluar nga data 14 nëntor 2017 e deri më 29 nëntor 2017, organizon Diskutime Publike, lidhur me shqyrtimin e procesit tarifor tre vjeçar 2018-2020, së bashku me Kompanitë Rajonale të Ujit (KRU).
- **Publikimi i orareve të takimeve të KKK:** me qëllim të informimit të konsumatorëve, sensibilizimit e opinionit për rolin e KKK-ve, si dhe për të inkurajuar konsumatorët për pjesëmarrje në takime të KKK, ARRU përmes gazetave ditore çdo muaj ka publikuar orarin e takimeve mujore të KKK në shtyp dhe në ueb-faqen e ARRU-së.

Përmes ueb faqes www.arru-rks.org konsumatorët kanë mundësi të informohen detajshet lidhur me të gjitha aktivitetet e ARRU-së dhe KKK-ve.

6. REKOMANDIMET

Përmirësimi, avancimi dhe zhvillimi i këtij sektori jetik për qytetarët kërkon angazhimin maksimal të të gjitha institucioneve në përputhje me përgjegjësitë e tyre institucionale, si dhe angazhimin e drejtpërdrejtë të konsumatorëve.

- Aprovimin në afat sa më të shkurtër nga Kuvendi i Republikës së Kosovës për Plotësim Ndryshimin e Ligjit për Rregullimin e shërbimeve të ujit, me qëllim të forcimit të bazës së veprimtarisë së ARRU (sqarimet detale rreth arsyeve për plotësim i janë paraqitur Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis e Planifikim Hapësinor).
- Me qëllim të ruajtjes së rezervave ujore, si dhe zvogëlimit të shpenzimeve për trajtimin dhe shpërndarjen e ujit të trajtuar, Qeveria e Republikës së Kosovës si aksionare duhet të i obligojë ofruesit e shërbimeve zbatimin e “Kornizën strategjike për zvogëlimin e ujit të pafaturuar”, strategji kjo e hartuar nga zyra e Kryeministrit.
- Vendosjen dhe zbatimin e marrëveshjes së performancës ndërmjet Njësisë së Politikave dhe Monitorim për Ndërmarrjet Publike (MZHE) dhe Bordeve të Drejtorëve për Kompanitë Rajonale të Ujësjellësit, bazuar në indikatorët e performancës dhe planeve të biznesit të aprovuara nga Autoriteti Rregullator për Shërbime të Ujit.
- Qeveria së bashku me Kuvendet Komunale, ofruesit e shërbimeve dhe ARRU të vazhdojë angazhimin për integrimin e sistemeve rurale në kuadër të Kompanive Rajonale (sistemet të cilat nuk menaxhohen nga KRU-të).
- Kuvendet Komunale të mbështesin ofruesit e shërbimeve në aktivitetet për reduktimin e ujit të pa faturuar, ngritjen e nivelit të faturimit dhe ngritjen e kapaciteteve të ujit – zhvillimin e burimeve të reja.
- Gjatë përcaktimit të prioritetëve dhe planifikimit të investimeve, të gjitha palët e interesit në sektor (Qeveria, Kuvendet Komunale, ofruesit e shërbimeve, donatorët, etj) të kenë bashkëpunim dhe koordinim më të ngushtë me qëllim të përmbushjes së nevojave të qytetarëve.
- Të gjitha palët e interesit në sektor të kontribuojnë në vetëdijesimin e konsumatorëve sa i përket obligimeve të cilat konsumatorët i kanë (zvogëlimit të keqpërdorimeve, pagesave të rregullta etj.).

Aprovimi i këtyre rekomandimeve nga Kuvendi i Republikës së Kosovës dhe zbatimi i tyre nga të gjitha palët do të ndikojë në ngritjen e nivelit të shërbimeve me ujë dhe ngritjen e nivelit të performancës së ofruesëve të shërbimeve.

7. RAPORTI FINANCIAR

Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit, buxhetin e vet e siguron nga Buxheti i Kosovës, ndërsa Taksa Vjetore e Licencimit, e cila është e barabartë me shpenzimet buxhetore të ARRUsë, derdhet në buxhetin e Kosovës.

Të hyrat e planifikuara për vitin fiskal 2017 kanë qenë 360,037.00€ të inkasuara 352,784.00€ apo shprehur në përqindje 97.99%.

Borgjlinjë ndaj ARRU për vitin 2017 janë KRU 'Bifurkacioni' në vlerë prej 2,107.94; KRU 'Hidrodrini' 3,301.73€; dhe KRU 'Hidromorava' me 1,844.08€ gjithsejt 7,253.75€.

Borgjet nga vitet e kaluara: KRU 'Mitrovica' viti 2013 borgj 15,568.37€; viti 2014- 10,102.64€; viti 2015-26,738.00€; KDMK riprogramim 2,193.00€, Kompanitë Regjionale të Mbeturinave 364,681.68€ të cilat janë në proces gjyqësor.

Gjithesejt borgjet 426,537.16€

Lartësia e Taksës Vjetore të Licencimit për vitin 2017 ka qenë 1.12%, të faturimit bruto të KRUsve.

ARRU Vitin fiskal 2017 e ka filluar me 358,734.00 € buxhet të aprovuar nga Kuvendi i Kosovës. Me kërkesën e Ministrisë së Financave kemi kursyer 10,538.60€ euro dhe i kemi transferuar te kjo ministri për destincionin e kërkuar.

Buxheti pas korrjigimit ka qenë 348,195.00€, të shpenzuara 332,564.00€ apo shprehur në përqindje 95.51%.

Buxheti i planifikuar nuk është shpenzuar sipas planifikimit për arsye se me ndryshimin e Ligjit të Prokurimit kompetencat për të zhvilluar procedurat e prokurimit kanë kaluar te AQP dhe kjo ka qenë pengesa kryesore në mos shfrytëzimin e buxhetit sipas planifikimit.

Në mënyrë të detajuar gjeni Raportin Financiar për vitin 2017 të bashkangjitur në këtë dokument.

Tabela 15: Buxheti i ARRU për 2017

Kategoria e Shpenzimeve	Të buxhetuara (EUR)	Të realizuara (EUR)
Paga dhe Mëditje	207,197.40	207,197.40
Mallra dhe shërbime	134,495.00	121,989.97
Shpenzime Kapitale	-	-
Shërbimet Komunale/Publike	6,503.00	3376.69
Total Buxheti	348,195.00	332,564.00

ARRU buxhetin e vitit 2017 e ka shpenzuar në 95.51%.

7.1. TË HYRAT NGA TAKSAT E LICENCIMIT 2017

Tabela 16. Të hyrat nga TVL për 2017

Kategoria e Hyrave	Te faturuara (EUR)	Të inkasuara (EUR)
Te hyrat nga Taksa e Licencimit	360,037.00	352,784.00
Te hyrat nga borgjet		
Te hyrat nga denimet		
Te hyrat tjera		
Total Hyrat	360,037.00	352,784.00

Formatin e Raportit të detajuar financiar të aprovuar nga Komisioni Parlamentar për Buxhet dhe Financa Kuvendit të Republikës të Kosovës e keni të bashkangjitur (aneksi 1)

8. RAPORTIMI RRETH ADRESIMIT TË ZYRËS SË AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM

Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA) ka audituar ARRU-në për periudhën 1 janar -31 dhjetor 2016. Për vitin 2016 kemi pasur tetë rekomandime, ndërsa për vitin 2017 ende nuk jemi audituar nga ZKA.

Emri i Auditimit: Auditimi i Pasqyrave Financiare të ARRU-së, për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2016

Plani i Veprimit të Menaxhmentit - Për zbatimin e rekomandimeve nga Raporti i Auditimit të ZAP-it

Nr i rek.	Rekomandimet	Veprimi i menaxhmentit	Data e planifikuar e përfundimit	Personi përgjegjës
1	Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojë se është bërë një analizë për ti përcaktuar shkaqet për Theksim të Çështjes. Duhet të ndërmerren veprime për ti adresuar shkaqet në mënyrë sistematike dhe pragmatike për t'i hequr gabimet në prezantimin e vlerave të raportuara në PFV-të 2017. Edhe aspektet tjera të pajtueshmërisë gjatë përgatitjes së PVF-ve duhet të adresohen. Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar nuk duhet të dorëzohet përveç nëse ndaj draft PFV-ve janë aplikuar të gjitha kontrollet dhe rishikimet e nevojshme.	<p>1. ARRU në të ardhmen duhet të konsolidohet dhe të sigurohet që i gjithë stafi i cili merret me aspektet financiare me kohë dhe saktësi ti siguroj të dhënat financiare për përpilimin e PVF.</p> <p>2. Posa që të sigurohen të dhënat finale financiare të fillohet me përpilimin e PVF-ve në mënyrë që të sigurohet koha e mjaftueshme për kontrollim të PVF në mënyrë që të evitohen lëshimet e mundshme teknike para se të nënshkruhen edhe nga ZKA dhe të dërgohen në Thesar.</p> <p>3. Bashkëpunim më i ngushtë me Thesarin.</p>	Sipas afateve ligjore	<p>-Kryesuesi i Dep. të Adm. dhe Financave</p> <p>-Zyrtari për buxhet dhe financa.</p> <p>-Drejtori i ARRU.</p>
2	Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojë që plani i veprimit, rishikohet, duke analizuar shkaqet e rekomandimeve të pazbatuara, dhe të përcaktojë një afat tëri kohor, si dhe stafin llogaridhënës për	Është formuar një komision prej 3 zyrtarëve, për rishikimin edhe shkaqet për moszbatimin e rekomandimeve	20 Korrik 2017	<p>-Zëvendës Drejtori i ARRU.</p> <p>- Kryesuesi i Dep. të Adm. dhe Financave</p>

	<p>zbatimin e tyre. Në fokus fillestar duhet të jenë fushat e një rëndësie më të madhe. Zbatimi i këtij plani duhet të monitorohet në vazhdimësi.</p>			<p>- Zyrtares për buxhet dhe financa.</p>
<p>3</p>	<p>Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojë se është rishikuar plotësimi i pyetësorit të vetëvlerësimit dhe është bërë adresimi i fushave me dobësi në mënyrë pro-aktive. Duhet të aplikohet një mekanizëm për ta konfirmuar saktësinë e pyetësorit me dokumentacionin mbështetës.</p>	<p>-ARRU do ta hartoj planin strategjik 2018-2020 dhe në planet e punës vjetore ti bëjë të qarta objektivat planin dinamik dhe listën e rreziqeve të cilat mund të pengojnë ARRU-n në arritjen e objektivave të planifikuara. Përveç identifikimit të rreziqeve ARRU duhet të planifikoj hapat e veprimit për menaxhimin e riskut.</p> <p>-Secili departament duhet të specifikoj objektivat e veta të cilat inkorporohen në planin vjetor të punës dhe njëkohësisht të identifikoj riskun dhe veprimet për menaxhimin e tij.</p> <p>-ARRU, ka caktuar personat përgjegjës për pyetësorin duke përfshirë edhe mekanizmat që duhet përdorur për ti mbështetur përmirësimet operative</p>	<p>Në vazhdimësi duke filluar menjëherë.</p> <p>-Plani i punës për vitin 2018, të jetë i përfunduar deri më 31 dhjetor 2017</p> <p>-Plani Strategjik 2018-2020, i përfunduar më së largu deri më 31 dhjetor 2017</p>	<p>-Zëvendës Drejtori i ARRU-s,</p> <p>-Kryesuesi i Dep. për Adm. dhe Fin. dhe të gjithë kryesuesit e departamenteve.</p> <p>-Pyetësorin e vetëvlerësimit, planin e punës për vitin 2018 dhe Planin Strategjik e miraton Drejtori i ARRU.</p>

4	<p>Drejtori i Përgjithshëm duhet të përcaktoj se pse monitorimi i KRU-ve nuk ka qenë efektiv dhe të ndërmarrë veprimet e duhura për të siguruar aplikim të drejtë dhe të vazhdueshëm të tarifave të KRU-ve ndaj konsumatorëve. Drejtori i Përgjithshëm duhet t'i zbatojë procedurat e përcaktuara pas paralajmërimit në përputhje me afatet ligjore.</p>	<p>Inspektim i menjëhershëm.</p>	<p>20 Korrik 2017</p>	<p>-Inspektori i ARRU dhe</p> <p>-Kryesuesi i Dep. të Tarifave.</p> <p>-Drejtori i ARRU</p>
5	<p>Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojë se është kryer një rishikim për të përcaktuar formën e raportimit financiar dhe operativ tek menaxhmenti i lartë, nga i cili kërkohet që të mbështesë menaxhimin efektiv të veprimtarisë dhe të sigurojë se është vendosur një zgjidhje e përshtatshme deri më 1 tetor 2017.</p>	<p>Secili kryesues i departamentit duhet të obligoj stafin e vet që të raportojnë se paku në baza mujore për punën dhe aktivitetet e tyre me shkrim, pastaj secili kryesues i departamentit të raportoj me shkrim tek drejtori i ARRU-s po ashtu në baza mujore.</p> <p>Raportimi në baza mujore më lehtë do të identifikonte dobësitë dhe përparësitë e aktiviteteve operative dhe financiare në ARRU dhe një mundësi më e mire e planifikimeve operative financiare të ARRU-s.</p> <p>Raporti duhet ta ketë formatin i cili</p>	<p>Në vazhdimësi duke filluar nga 01 Gusht 2017, raportet me shkrim.</p> <p>-Plani i punës për vitin 2018, të jetë i përfunduar deri më 31 dhjetor 2017</p> <p>-Plani Strategjik 2018-2020, i përfunduar më së largu deri më 31 dhjetor 2017</p>	<p>-Kryesuesi i Dep. për Adm. dhe Fin. në bashkëpunim me Kryesuesit tjerë të departamenteve, dhe nën mbikëqyrjen e Zëvendës drejtorit.</p> <p>-Planin e punës për vitin 2018 dhe Planin Strategjik e miraton drejtori i ARRU</p>

		<p>është i lehtë për tu kuptuar dhe i cili përfshin informacionet e nevojshme si operative po ashtu edhe financiare.</p> <p>Raportime me goje do të bëhen çdo ditë sipas nevojë, dhe çdo të hëne takim i përbashkët me stafin e lartë të drejtorit i ARRU-s.</p> <p>Respektimi rigoroz i të gjithë të punësuarve i Rregullores së brendshme nr. 02-AF/2016, për kontrollin financiar</p>		
6	<p>Drejtori i Përgjithshëm duhet t'i identifikojë mekanizmat efektiv që parandalojnë operimin e KRU-ve pa licenca dhe t'i vendos kontrollet për zbatim të plotë të tyre. Kjo mund të përfshijë informimin e Kuvendit të Kosovës për nevojën e emërimit me kohë të pozitës së Drejtorit të Përgjithshëm.</p> <p>Raportimet/harmonizimet mujore me Thesarin duhet të kryhen në baza të rregullta për të siguruar pajtueshmëri me Rregulloren dhe që vlerat e të hyrave janë të sakta dhe të plota.</p>	<p>-KRU kanë funksionuar pa licencë shërbimi, për shkak të vonesës së emërimit nga ana e Kuvendit të Drejtorit dhe Zëvendës Drejtorit. Kuvendi është informuar me kohë dhe atë me dt. 17.12.2014, me shkresën zyrtare me nr. Prot. 536/D. Pas emërimit të Drejtorit menjëherë është bërë Licencimi i KRU. Ky rekomandim për këtë çështje është i plotësuar.</p> <p>-Barazimet mujore me MF/Thesarin, për inkasimin e të hyrave do të bëhet sipas rregullës financiare. 03/2010 për të hyrat/</p>	Menjëherë.	Zyrtari i të hyrave ne bashkëpunim me Kryesuesin e Dep. për Adm. dhe Financa
7	Drejtori i Përgjithshëm duhet t'i	-ARRU me dt. 26 tetor 2016, ka bërë	Menjëherë	Drejtori i ARRU.

	<p>rishikojë arsyet e mosrealizimit të rekrutimeve dhe të sigurojë se janë ndërmarrë veprime për të adresuar çështjet e ngritura, si dhe për të shmangur pengesat e tilla në të ardhmen. Po ashtu duhet ta rishikojë pozicionin e Zyrtarit Certifikues brenda institucionit për të siguruar pavarësinë dhe funksionimin e tij sipas kërkesave mbi MFK-në.</p>	<p>kërkesën me nr. Prot 554, për mjete shtesë për paga. Nuk është realizuar.</p> <p>-Kërkesën e dytë MF për shtim të buxhetit në paga për dy pozita MF, më dt. 03.07.2017.</p> <p>-Zyrtari certifikues është paraparë në Rregulloren Nr. 03-OB 2016, për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në ARRU. Për shkak të numrit të pakët të stafit të ARRU, ky zyrtar e kryen edhe punën e Analistit financiar të tarifave, dhe mendoj se nuk është në kundërshtim me Ligjin. Nuk kemi alternativ tjetër.</p>		
8	<p>Drejtori i Përgjithshëm në bashkëpunim me Ministrinë e Administratës Publike duhet t'i analizoj arsyet e mos përdorimit të sistemit e-pasuria dhe të shqyrtojë nevojën e trajnimeve të stafit për të siguruar se regjistrimi dhe menaxhimi i pasurisë bëhet në përputhje me kërkesat e Rregullores.</p>	<p>Sistemi E-pasuria, në bashkëpunim me MAP, është konfiguruar për nevojat e shfrytëzimit në ARRU. Më dt. 15 korrik të këtij viti fillon futja e të dhënave. Parashihet një trajnim i stafit nga MAP.</p>	15 Korrik 2017	<p>-Kryesuesi i Dep. Adm. dhe Financa</p> <p>-Zyrtari i pranimit dhe zyrtare tjerë.</p>

Shtojca 1: Raporti Financiar për vitin 2016 sipas formatit të aprovuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës

Adresa e ARRU

Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit

Rruga: Ali Pashë Tepelena, Nr. 1

E-mail: info@arru-rks.org

Ueb: <http://www.arru-rks.org/>